22	**Akademia e Shkencës**	**543,143**	**10,000**	**0**	**10,000**	**553,143**
01520	Veprimtaria akademike	543,143	10,000	0	10,000	553,143
24	**Kontrolli i Lartë i Shtetit**	**724,061**	**5,000**	**0**	**5,000**	**729,061**
01120	Veprimtaria Audituese e KLSH-së	724,061	5,000	0	5,000	729,061
26	**Ministria e Mjedisit**	**1,466,396**	**493,600**	**590,000**	**1,083,600**	**2,549,996**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	343,577	3,000	0	3,000	346,577
05320	Programe për mbrojtjen e mjedisit	490,513	290,000	390,000	680,000	1,170,513
04260	Administrimi i pyjeve	632,306	200,600	0	200,600	832,906
06220	Menaxhimi i mbetjeve urbane	0	0	200,000	200,000	200,000
28	**Prokuroria e Përgjithshme**	**3,286,103**	**130,000**	**0**	**130,000**	**3,416,103**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	3,286,103	130,000	0	130,000	3,416,103
29	**Këshilli i Lartë Gjyqësor**	**5,650,120**	**1,372,500**	**0**	**1,372,500**	**7,022,620**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	489,132	15,000	0	15,000	504,132
01140	Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë	20,967	0	0	0	20,967
03310	Buxheti gjyqësor	5,140,021	1,357,500	0	1,357,500	6,497,521
30	**Gjykata Kushtetuese**	**265,607**	**4,000**	**0**	**4,000**	**269,607**
03320	Veprimtaria Gjyqësore Kushtetuese	265,607	4,000	0	4,000	269,607
31	**Agjencia Telegrafike Shqiptare**	**102,686**	**2,000**	**0**	**2,000**	**104,686**
08320	Veprimtaria telegrafike e ATSH-së	102,686	2,000	0	2,000	104,686
35	**Këshilli i Lartë i Prokurorisë**	**228,983**	**2,000**	**0**	**2,000**	**230,983**
01110	Veprimtaria e KLP-së	228,983	2,000	0	2,000	230,983
40	**Partitë politike**	**355,800**	**0**	**0**	**0**	**355,800**
01110	Mbështetje për partitë politike	345,600	0	0	0	345,600
01120	Mbështetje për shoqatat	8,000	0	0	0	8,000
01130	Mbështetje për organizatat e veteraneve me status	2,200	0	0	0	2,200
41	**Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar**	**1,910,865**	**210,000**	**0**	**210,000**	**2,120,865**
03390	Veprimtaria e SPAK-ut	1,910,865	210,000	0	210,000	2,120,865
50	**Instituti i Statistikës**	**1,175,162**	**15,600**	**100,000**	**115,600**	**1,290,762**
01320	Veprimtaria Statistikore	1,175,162	15,600	100,000	115,600	1,290,762
55	**Shkolla e Magjistraturës**	**408,604**	**13,840**	**0**	**13,840**	**422,444**
09820	Veprimtaria arsimore	408,604	13,840	0	13,840	422,444
56	**Fondi Shqiptar i Zhvillimit**	**0**	**17,518,404**	**7,921,178**	**25,439,582**	**25,439,582**
06210	Programe Zhvillimi	0	9,487,411	7,921,178	17,408,589	17,408,589
06220	Infrastruktura vendore dhe rajonale	0	5,272,636	0	5,272,636	5,272,636
04230	Programi "100 Fshatrat"	0	2,758,357	0	2,758,357	2,758,357
57	**Qendra Kombëtare e Kinematografisë**	**186,415**	**1,000**	**0**	**1,000**	**187,415**
08220	Mbështetja e veprimtarisë kinematografike	186,415	1,000	0	1,000	187,415
63	**Institucionet e sistemit të drejtësisë**	**349,525**	**5,500**	**0**	**5,500**	**355,025**
03320	Veprimtaria e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë	349,525	5,500	0	5,500	355,025
03340	Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar	0	0	0	0	0
66	**Avokati i Popullit**	**208,554**	**3,000**	**0**	**3,000**	**211,554**
03320	Shërbimi i avokatisë	208,554	3,000	0	3,000	211,554
67	**Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil**	**118,425**	**2,000**	**0**	**2,000**	**120,425**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	118,425	2,000	0	2,000	120,425
73	**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**	**354,470**	**1,500**	**0**	**1,500**	**355,970**
01610	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	354,470	1,500	0	1,500	355,970
01620	Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	0	0	0	0	0

Kodi	Emërtimi i institucionit/programit	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale	
76	**Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave**	**263,029**	**63,000**	**0**	**63,000**	**326,029**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	263,029	63,000	0	63,000	326,029
77	**Autoriteti i Konkurrencës**	**125,271**	**1,000**	**0**	**1,000**	**126,271**
04120	Mbikëqyrja e tregut dhe garantimi i konkurrencës	125,271	1,000	0	1,000	126,271
82	**Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit**	**18,573**	**1,000**	**0**	**1,000**	**19,573**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	18,573	1,000	0	1,000	19,573
87	**Institucione të tjera qeveritare**	**12,623,757**	**5,806,036**	**2,125,066**	**7,931,102**	**20,554,859**
01320	Shërbime qeveritare	400,000	366,749	0	366,749	766,749
01130	Shërbimi i Prokurimit Publik	114,470	1,000	0	1,000	115,470
05640	Administrimi i ujërave	149,951	10,000	26,986	36,986	186,937
03310	Shërbimi i Avokatisë Shtetërore	349,724	2,000	0	2,000	351,724
01150	Shërbime të tjera	1,420,954	68,000	80,780	148,780	1,569,734
01140	e-Qeverisja	9,650,688	5,342,287	2,017,300	7,359,587	17,010,275
01330	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike	281,458	15,000	0	15,000	296,458
08480	Mbështetje për kultet fetare	256,512	1,000	0	1,000	257,512
88	**Mbështetje për Shoqërinë Civile**	**137,590**	**1,000**	**0**	**1,000**	**138,590**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	137,590	1,000	0	1,000	138,590
89	**Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**	**193,472**	**1,000**	**0**	**1,000**	**194,472**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	193,472	1,000	0	1,000	194,472
90	**Komisioni i Prokurimit Publik**	**126,945**	**2,000**	**0**	**2,000**	**128,945**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	126,945	2,000	0	2,000	128,945
91	**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**	**78,045**	**2,000**	**0**	**2,000**	**80,045**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	78,045	2,000	0	2,000	80,045
92	**Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit**	**61,902**	**1,000**	**0**	**1,000**	**62,902**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	61,902	1,000	0	1,000	62,902
95	**Autoriteti për të Drejtën e Informimit**	**181,578**	**3,000**	**0**	**3,000**	**184,578**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	181,578	3,000	0	3,000	184,578
	TOTALI	**336,075,625**	**136,729,000**	**50,885,300**	**187,614,300**	**523,689,925**

Tab. 2

Kod min.	Emërtimi i ministrisë/Institucionit buxhetor	Numri i punonjësve AN 2026
1	Presidenca	93
2	Kuvendi	489
3	Kryeministria	218
4	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit	3,201
5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	2,638
6	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1,310
10	Ministria e Financave	3,273
11	Ministria e Arsimit	30,877
12	Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit	1,239
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	4,431
14	Ministria e Drejtësisë	5,391
15	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	617
16	Ministria e Punëve të Brendshme	15,730
17	Ministria e Mbrojtjes	9,599
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	998
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	175
22	Akademia e Shkencës	29
24	Kontrolli i Lartë i Shtetit	243
26	Ministria e Mjedisit	754
28	Prokuroria e Përgjithshme	979
29	Këshilli i Lartë Gjyqësor	1,992
30	Gjykata Kushtetuese	101
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	40
35	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	77
41	SPAK/BKH	339
50	Instituti i Statistikës	260
55	Shkolla e Magjistraturës	42
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	13
63	Kolegji i Posaçëm i Apelimit	0
63	Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	101
66	Avokati i Popullit	70
67	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	45
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	95
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	80
77	Autoriteti i Konkurrencës	53
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6
87	**Institucione të tjera Qeveritare**	**1,406**
1	*Drejtoria Sigurimit të Informacionit Klasifikuar (DSIK)*	*38*
2	*Agjencia e Prokurimit Publik*	*52*
3	*Komiteti për Pakicat Kombëtare*	*24*
4	*Inspektorati Qendror*	*98*
5	*Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore*	*82*
6	*Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje*	*70*

Kod min.	Emërtimi i ministrisë/Institucionit buxhetor	Numri i punonjësve AN 2026
7	*Agjencia e Zhvillimit të Territorit*	*0*
8	*Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit*	*41*
9	*Agjencia Autonome e Auditimit të Fondeve të BE-së*	*23*
10	*Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit*	*329*
11	*Komiteti Shtetëror i Kulteve*	*10*
12	*Departamenti i Administratës Publike*	*66*
13	*Shkolla Shqiptare e Administratës Publike*	*22*
14	*Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit*	*27*
15	*Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK)*	*159*
16	*Sekretariati Teknik i KEK*	*0*
17	*Autoriteti Shtetëror Gjeohapsinor (ASIG)*	*73*
18	*Avokatura e Shtetit*	*107*
19	*Agjencia Kombëtare e Rinisë*	*0*
20	*Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës*	*69*
22	*Agjencia e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore*	*32*
23	*Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve*	*15*
24	*Agjencia për Media dhe Informim*	*69*
88	Agjencia për Mbështetje për Shoqërinë Civile	16
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	70
90	Komisioni i Prokurimit Publik	42
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	34
92	Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	22
95	Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit	73
	Total punonjës buxhetorë	**87,261**
	Rezervë për institucione të qeverisjes qendrore	**100**
	Total numri i punonjësve	**87,361**

Tab. 3

Transferta e pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2026

Në mijë lekë

Nr	Bashkitë	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme 2026	Shtesë me AN nga rritja e PBB-së 2026 në transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme	Transfertat e pakushtëzuara sektoriale												Totali
				Konviktet e arsimit parauniversitar	Arsimi parashkollor		Arsimi parauniversitar	Mbrojtja nga zjarri	Shtesë me AN mbrojtja nga zjarri	Mbrojtja sociale	Administrimi i pyjeve	Rrugët	Ujitja dhe kullimi	Rritja e nivelit të pagave	Mena-xhimi i mbetjeve urbane	
					Ndarë me formulë për personelin mësimor	Për stafin mbështetës										
1	Belsh	189,704	673	0	43,955	1,963	1,935	21,634	1,007	0	1,289	10,324	12,296	45,771	6,800	**337,352**
2	Berat	520,520	1,848	31,137	172,156	65,315	21,216	50,978	2,915	26,994	8,337	6,362	18,820	90,995	0	**1,017,593**
3	Bulqizë	394,224	1,399	0	88,369	16,086	0	28,449	1,095	0	19,661	37,674	16,564	60,480	0	**664,001**
4	Cërrik	236,909	841	5,227	73,706	8,738	8,555	21,822	1,007	0	3,087	2,371	19,918	44,075	10,800	**437,055**
5	Delvinë	95,547	339	0	33,515	8,164	2,833	21,779	1,276	0	3,714	4,447	12,296	33,276	0	**217,187**
6	Devoll	313,822	1,114	0	90,120	5,472	3,899	22,047	1,095	0	6,764	13,696	14,553	57,504	7,600	**537,686**
7	Dibër	604,699	2,146	27,379	203,168	48,169	14,565	42,030	1,825	0	12,115	18,467	17,692	102,548	0	**1,094,803**
8	Divjakë	310,931	1,104	0	88,894	2,450	2,016	20,978	1,095	0	1,294	10,227	38,563	57,741	24,800	**560,093**
9	Dropull	132,995	472	0	4,445	574	1,821	21,634	1,007	0	6,704	6,620	7,858	34,316	9,300	**227,745**
10	Durrës	1,505,831	5,345	25,861	312,130	82,460	29,855	102,198	4,375	0	4,735	31,563	58,171	190,051	225,100	**2,577,674**
11	Elbasan	1,058,392	3,757	32,357	367,044	94,706	52,828	75,464	2,735	24,011	17,923	22,976	18,820	181,393	56,000	**2,008,405**
12	Fier	948,898	3,368	24,198	279,714	67,763	17,285	69,316	3,100	29,616	5,957	11,203	75,961	184,356	95,000	**1,815,735**
13	Finiq	199,757	709	0	14,536	1,948	0	34,070	1,369	0	5,417	3,690	19,949	40,697	0	**322,142**
14	Fushë Arrëz	114,076	405	0	37,497	16,329	7,374	29,602	1,276	0	26,266	17,656	3,591	37,205	1,000	**292,277**
15	Gjirokastër	317,032	1,125	20,554	151,263	40,822	9,528	47,364	2,555	0	10,454	10,074	12,126	64,420	24,600	**691,918**
16	Gramsh	315,138	1,119	7,343	115,026	14,695	5,814	26,044	1,276	0	21,669	25,543	12,296	55,345	6,800	**608,106**
17	Has	210,976	749	7,654	55,110	5,472	4,673	23,729	1,007	0	20,897	2,095	13,966	43,667	0	**389,995**
18	Himarë	175,545	623	0	24,395	1,390	971	24,446	1,276	0	11,696	5,867	12,296	46,390	24,100	**328,996**
19	Kamzë	849,834	3,017	0	328,548	45,816	15,928	64,723	3,645	0	626	0	4,719	174,377	35,700	**1,527,134**
20	Kavajë	333,715	1,185	14,470	116,725	27,759	10,140	27,251	1,460	0	1,294	7,366	25,344	95,735	54,600	**717,043**
21	Këlcyrë	95,740	340	0	13,362	2,450	4,568	21,828	1,095	0	4,705	10,074	12,296	29,549	16,200	**212,207**
22	Klos	203,871	724	0	43,121	8,981	2,848	21,634	1,095	0	11,035	13,226	3,591	42,595	0	**352,720**
23	Kolonjë	175,908	624	11,053	52,706	8,981	6,508	24,733	1,095	0	21,844	11,731	21,781	38,884	7,600	**383,448**
24	Konispol	95,864	340	0	17,794	1,963	0	21,634	1,276	0	2,520	2,271	13,425	26,505	0	**183,592**
25	Korçë	665,252	2,361	24,890	235,388	71,029	29,912	48,414	2,915	0	22,420	8,601	59,678	128,979	7,600	**1,307,439**
26	Krujë	446,568	1,585	0	136,604	26,699	5,723	34,007	1,460	0	8,724	9,346	21,077	65,918	39,000	**796,710**
27	Kuçovë	280,052	994	0	97,373	30,208	10,575	24,770	1,276	2,982	2,219	2,646	16,564	50,568	0	**520,227**
28	Kukës	533,326	1,893	22,109	148,313	51,435	7,734	81,815	4,375	2,843	16,594	25,252	7,858	98,067	0	**1,001,614**
29	Kurbin	347,013	1,232	0	134,937	35,441	23,749	27,096	1,369	0	4,315	5,087	26,472	67,843	11,100	**685,655**
30	Lezhë	510,434	1,812	10,578	165,519	44,904	24,905	56,733	3,010	0	11,716	6,802	29,857	100,228	7,800	**974,298**
31	Libohovë	60,261	214	0	9,993	1,963	1,833	21,634	1,095	0	3,918	8,347	3,600	17,128	5,000	**134,987**
32	Librazhd	405,235	1,438	0	112,637	16,086	4,917	29,938	1,276	0	13,012	31,657	16,564	67,345	7,000	**707,105**
33	Lushnjë	622,970	2,211	10,521	226,936	50,376	17,985	37,675	1,276	0	2,528	9,634	61,936	121,859	44,800	**1,210,706**
34	Malësi e Madhe	428,902	1,522	4,786	91,268	4,898	8,378	38,552	1,825	0	23,683	16,972	16,794	70,618	5,500	**713,698**
35	Maliq	440,296	1,563	0	128,412	6,045	15,981	30,519	1,369	0	8,496	11,401	52,027	72,331	7,600	**776,041**
36	Mallakastër	230,963	820	0	93,678	25,309	10,357	23,498	1,095	0	4,357	9,414	16,564	51,502	25,400	**492,958**
37	Mat	284,993	1,012	14,337	89,922	30,208	11,053	25,117	1,276	0	13,059	33,048	14,522	71,983	0	**590,529**
38	Memaliaj	151,754	539	0	52,487	8,164	11,936	21,856	1,095	0	4,834	5,757	3,600	36,102	11,600	**309,724**
39	Mirditë	291,820	1,036	24,892	77,815	27,221	12,065	38,256	1,276	0	22,095	24,613	18,790	66,741	0	**606,618**
40	Patos	188,943	671	0	69,228	20,411	5,656	27,385	1,007	0	1,253	2,372	18,329	59,729	11,900	**406,884**
41	Peqin	198,539	705	0	62,664	7,922	5,765	22,383	1,007	0	2,193	5,656	12,296	58,283	16,000	**393,413**
42	Përmet	171,881	610	7,467	35,729	8,164	7,268	25,572	1,095	0	8,542	8,923	12,296	44,273	13,800	**345,621**
43	Pogradec	530,931	1,885	0	216,188	12,004	15,103	35,521	1,276	0	22,180	26,776	13,425	98,488	9,500	**983,277**
44	Poliçan	143,751	510	0	43,566	10,766	7,692	23,345	1,007	0	5,655	4,484	4,491	35,429	0	**280,697**
45	Përrenjas	255,010	905	0	69,955	7,679	5,461	24,382	1,095	0	10,719	24,126	14,522	49,115	9,800	**472,769**
46	Pukë	161,909	575	15,556	49,522	20,411	11,582	27,885	1,008	0	18,056	8,452	3,591	43,668	2,600	**364,813**
47	Pustec	51,123	181	0	9,885	355	0	24,971	1,276	0	1,274	407	6,930	21,934	7,600	**125,937**
48	Roskovec	162,745	578	0	49,337	3,839	3,726	21,634	1,276	0	1,253	5,181	8,987	59,967	13,800	**332,322**
49	Rrogozhinë	215,353	764	0	52,070	9,554	3,770	20,978	1,095	0	2,166	0	12,296	48,737	19,300	**386,084**
50	Sarandë	224,198	796	20,897	73,234	21,227	5,478	28,670	1,460	0	3,782	0	7,858	65,902	41,000	**494,503**
51	Selenicë	251,466	893	0	44,287	7,105	14,147	23,855	1,095	0	6,834	3,596	19,235	45,203	0	**417,716**
52	Shijak	215,249	764	0	61,546	10,614	4,751	26,531	1,369	0	1,294	62	7,858	48,045	20,300	**398,383**
53	Shkodër	982,156	3,486	65,848	214,222	86,542	39,740	72,901	3,190	66,890	16,761	24,505	36,552	128,593	15,300	**1,756,685**
54	Skrapar	181,808	645	12,603	57,459	18,625	13,368	27,932	1,276	0	14,879	16,542	17,861	47,575	0	**410,574**
55	Tepelenë	136,344	484	7,654	53,839	13,063	5,627	22,241	1,095	0	7,690	8,060	3,599	32,872	15,500	**308,066**
56	Tiranë	4,277,288	15,182	102,263	994,752	422,910	140,269	294,877	16,850	0	14,567	25,886	26,397	297,050	0	**6,628,291**
57	Tropojë	299,807	1,064	0	69,005	18,777	5,680	25,616	1,369	0	21,365	11,403	4,148	46,819	0	**505,054**
58	Dimal	227,756	808	0	77,040	574	2,378	21,779	1,369	0	1,274	4,928	23,258	49,332	0	**410,495**
59	Vau i Dejës	328,750	1,167	9,919	64,866	1,147	3,747	20,978	1,550	21,859	9,757	7,466	15,681	74,244	2,100	**563,231**
60	Vlorë	852,421	3,026	29,311	332,779	106,951	49,907	69,205	3,740	0	8,490	3,353	50,883	118,220	0	**1,628,485**
61	Vorë	198,376	704	0	70,854	3,839	7,625	20,978	1,550	0	1,290	639	12,296	76,342	23,100	**417,595**
Totali		**25,355,570**	**90,000**	**590,864**	**7,280,608**	**1,820,929**	**781,003**	**2,314,884**	**114,000**	**175,194**	**573,244**	**687,118**	**1,165,587**	**4,415,108**	**1,000,000**	**46,364,109**

Tab. 4

TREGUESIT FISKALË TË BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2023–2028
Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2023-2028

Nr.	E M E R T I M I	AN 2026 qershor	Në % të PBB	Buxheti 2027	Në % të PBB	Buxheti 2028	Në % të PBB
	TOTALI TË ARDHURAVE	**843,110**	**30.2%**	**892,541**	**30.4%**	**942,753**	**32.1%**
I.	**Të ardhura nga ndihmat**	**15,249**	**0.5%**	**24,297**	**0.8%**	**26,901**	**0.9%**
	Nga të cilat: mbështetje buxhetore	*1,000*	*0.0%*	*1,000*	*0.0%*	*1,050*	*0.0%*
	Nga të cilat: projekte të destinuara për investime	*14,249*	*0.5%*	*23,297*	*0.8%*	*25,851*	*0.9%*
II.	**Të ardhura tatimore**	**798,088**	**28.6%**	**838,121**	**28.6%**	**884,860**	**30.2%**
II.1	**Nga tatimet dhe doganat**	**538,258**	**19.3%**	**569,014**	**19.4%**	**602,942**	**20.5%**
	Tatimi mbi vlerën e shtuar	248,023	8.9%	264,867	9.0%	282,440	9.6%
	Tatimi mbi fitimin	60,742	2.2%	64,061	2.2%	67,760	2.3%
	Akcizat	73,660	2.6%	78,790	2.7%	83,339	2.8%
	Tatimi mbi të ardhurat personale	96,321	3.5%	98,575	3.4%	103,170	3.5%
	Taksa nacionale dhe të tjera	48,806	1.7%	51,473	1.8%	54,394	1.9%
	Taksa Doganore	10,705	0.4%	11,247	0.4%	11,840	0.4%
II.2	**Të ardhura nga pushteti vendor**	**57,932**	**2.1%**	**58,644**	**2.0%**	**60,252**	**2.1%**
	Taksa lokale	47,895	1.7%	47,953	1.6%	49,162	1.7%
	Tatimi mbi pasurinë (ndërtesat)	10,037	0.4%	10,691	0.4%	11,090	0.4%
II.3	**Të ardhurat nga fondet speciale**	**201,898**	**7.2%**	**210,463**	**7.2%**	**221,666**	**7.6%**
	Sigurimi shoqëror	174,349	6.2%	181,668	6.2%	191,370	6.5%
	Sigurimi shëndetësor	26,549	1.0%	27,795	0.9%	29,296	1.0%
	Të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve	1,000	0.0%	1,000	0.0%	1,000	0.0%
III.	**Të ardhura jotatimore**	**29,773**	**1.1%**	**30,123**	**1.0%**	**30,993**	**1.1%**
	Transferta e fitimit nga Banka e Shqipërisë	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%
	Të ardhura nga institucionet buxhetore	16,173	0.6%	16,273	0.6%	16,473	0.6%
	Dividenti	300	0.0%	300	0.0%	320	0.0%
	Tarifat e Shërbimeve	3,800	0.1%	4,000	0.1%	4,100	0.1%
	Të tjera	9,500	0.3%	9,550	0.3%	10,100	0.3%
	TOTALI I SHPENZIMEVE	**906,817**	**32.5%**	**960,370**	**32.7%**	**1,005,649**	**34.3%**
I.	**Shpenzime korrente**	**727,840**	**26.1%**	**758,363**	**25.8%**	**797,159**	**27.2%**
1	**Personeli**	**141,881**	**5.1%**	**143,597**	**4.9%**	**152,472**	**5.2%**
	Paga	120,348	4.3%	122,012	4.2%	122,807	4.2%
	Kontributi për sigurime shoqërore	19,973	0.7%	19,585	0.7%	19,684	0.7%
	Fondi i veçantë i pagave	560	0.0%	1,000	0.0%	1,000	0.0%
	Indeksimi i Pagave	0	0.0%	0	0.0%	7,981	0.3%
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	1,000	0.0%	1,000	0.0%	1,000	0.0%
2	**Interesat**	**63,807**	**2.3%**	**68,492**	**2.3%**	**73,256**	**2.5%**
	Të brendshme	35,153	1.3%	38,161	1.3%	41,091	1.4%
	Të huaja	22,254	0.8%	23,581	0.8%	25,165	0.9%
	Kontingjencë për risqet e borxhit	6,400	0.2%	6,750	0.2%	7,000	0.2%
3	**Shpenzime operative mirëmbajtjeje nga të cilat:**	**88,112**	**3.2%**	**85,999**	**2.9%**	**86,098**	**2.9%**
	Të qeverisjes qendrore	*84,212*	*3.0%*	*81,999*	*2.8%*	*81,998*	*2.8%*
	Arsimi i Lartë nga të ardhurat e veta	*1,000*	*0.0%*	*1,000*	*0.0%*	*1,000*	*0.0%*
	Të tjera jashtë limitit	*2,900*	*0.1%*	*3,000*	*0.1%*	*3,100*	*0.1%*
4	**Subvencionet**	**2,450**	**0.1%**	**2,450**	**0.1%**	**2,450**	**0.1%**
5	**Shpenzime për fondet speciale**	**289,395**	**10.4%**	**310,375**	**10.6%**	**331,264**	**11.3%**
	Sigurime shoqërore	204,960	7.3%	214,919	7.3%	224,438	7.6%
	Politika të reja pensionesh	1,653	0.1%	2,653	0.1%	2,773	0.1%
	Bonusi i pensionistëve	10,000	0.4%	20,000	0.7%	30,000	1.0%
	Sigurime shëndetësore	69,282	2.5%	69,303	2.4%	70,053	2.4%
	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	3,500	0.1%	3,500	0.1%	4,000	0.1%
6	**Shpenzime për Buxhetin Vendor**	**111,971**	**4.0%**	**114,429**	**3.9%**	**118,119**	**4.0%**
	Transfertat nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor	47,519	1.7%	49,235	1.7%	50,967	1.7%
	Transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme	*27,904*	*1.0%*	*29,345*	*1.0%*	*30,922*	*1.1%*
	Transfertë e pakushtëzuar sektoriale (grant specifik)	*19,415*	*0.7%*	*19,690*	*0.7%*	*19,845*	*0.7%*
	Transfertë e pakushtëzuar sektoriale (grant performance)	*200*	*0.0%*	*200*	*0.0%*	*200*	*0.0%*
	Buxheti vendor (të ardhurat e veta tatimore)	57,932	2.1%	58,644	2.0%	60,252	2.1%
	Taksa të ndara	1,820	0.1%	1,850	0.1%	2,000	0.1%
	Buxheti vendor (të ardhurat e veta jotatimore)	3,200	0.1%	3,200	0.1%	3,400	0.1%
	Financimi i huaj vendor dhe të tjera të mbartura	1,500	0.1%	1,500	0.1%	1,500	0.1%
7	**Shpenzime të tjera**	**30,224**	**1.1%**	**33,020**	**1.1%**	**33,500**	**1.1%**
	Pagesa e papunësisë	1,000	0.0%	1,020	0.0%	1,100	0.0%
	Ndihma ekonomike dhe paaftësia	25,324	0.9%	27,700	0.9%	27,900	1.0%
	Kompensim për ish të përndjekurit politikë	1,600	0.1%	2,000	0.1%	2,000	0.1%
	Bonusi i lindjeve	2,300	0.1%	2,300	0.1%	2,500	0.1%
II.	**Fonde të tjera të pashpërndara**	**2,800**	**0.1%**	**5,500**	**0.2%**	**3,000**	**0.1%**
	Fondi rezervë	2,800	0.1%	3,000	0.1%	3,000	0.1%
	Rezerve për zgjedhjet			2,500	0.1%		
III.	**Shpenzime kapitale**	**176,177**	**6.3%**	**196,508**	**6.7%**	**205,490**	**7.0%**
	Financimi i brendshëm	128,165	4.6%	130,003	4.4%	136,729	4.7%
	nga e cila: Injektim kapitali i BZHSH-së	*1,000*	*0.0%*	*2,000*	*0.1%*	*3,000*	*0.1%*
	Investime nga të ardhurat e arsimit të lartë	1,000	0.0%	1,000	0.0%	1,000	0.0%
	Financimi i huaj	42,012	1.5%	62,505	2.1%	67,761	2.3%
	nga të cilat: Energjia	*2,000*	*0.1%*	*2,000*	*0.1%*	*2,000*	*0.1%*
	Plani i Rritjes me BE-në	*1,790*	*0.1%*	*14,134*	*0.5%*	*16,876*	*0.6%*
	Fondi i rindërtimit	5,000	0.2%	3,000			
	Transfertë kapitale për për llogarinë speciale të shpronësimeve						
	DEFICITI	**-63,707**	**-2.3%**	**-67,830**	**-2.3%**	**-62,895**	**-2.1%**
	FINANCIMI DEFICITIT	**63,707**	**2.3%**	**67,830**	**2.3%**	**62,895**	**2.1%**
	I brendshëm	**44,737**	**1.6%**	**44,954**	**1.5%**	**36,287**	**1.2%**
	Të ardhura nga privatizimi						
	Huamarrje e brendshme	50,000	1.8%	46,000	1.6%	39,000	1.3%
	Të tjera	-5,263	-0.2%	-1,046	0.0%	-2,713	-0.1%
	I huaj	**18,971**	**0.7%**	**22,876**	**0.8%**	**26,608**	**0.9%**
	Hua afatgjatë (e marrë)	29,264	1.0%	103,267	3.5%	105,969	3.6%
	Ndryshimi i gjendjes së arkës						
	Ripagesat	-32,613	-1.2%	-95,348	-3.2%	-94,409	-3.2%
	Mbështetje buxhetore	22,320	0.8%	14,957	0.5%	15,048	0.5%
	Produkti i Brendshëm Bruto (PBB)	***2,790,436***	***100.0%***	***2,934,532***	***100.0%***	***3,092,217***	***100.0%***

ANEKSI 11

Fondi Shqipar i Zhvillimit

Fondi prej 3 000 000 000 (tre miliardë) lekë në buxhetin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, përdoret sipas përcaktimeve mëposhtë:

a) Në masën 2 000 000 000 (dy miliardë) lekë për blerjen e makinerive, mjeteve, pajisjeve, teknologjive dhe infrastrukturën e nevojshme, në funksion të mbështetjes së njësive të vetëqeverisjes vendore me logjistikën përkatëse për kryerjen e shërbimeve rajonale e vendore, për mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrugëve rurale, hapësirave publike, transportin publik urban dhe logjistikën bashkiake, menaxhimin e flotës, ndërhyrjet në emergjenca, pastrim gjelbërim, kanale kullues, etj.

b) Në masën 1 000 000 000 (një miliardë) lekë për modernizimin e sistemit të transportit publik urban, në mbështetje të pajisjes së njësive të vetëqeverisjes vendore me mjete transporti elektrike.

c) Pajisjet, makineritë, logjistika dhe infrastruktura përkatëse e siguruar nga FSHZH sipas pikave a) dhe b) mësipër, shërbejnë si pjesmarrje në kapitalin e operatorit përkatës, përgjegjës për shërbimet dhe logjistikën bashkiake.

VENDIM
Nr. 509, datë 30.6.2026

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR PROJEKTIMIN EKOLOGJIK TË PRODUKTEVE ME NDIKIM ENERGJETIK, SI DHE KËRKESAVE PËR ETIKETIMIN E KËTYRE PRODUKTEVE [1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 7/1, të ligjit nr. 52/2024, "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. QËLLIMI

Ky vendim përcakton kërkesat e detajuara të projektimit ekologjik për pajisjet e ngrohjes lokale me lëndë djegëse të ngurtë, me qëllim:

a) rritjen e eficiencës sezonale të ngrohjes;

b) reduktimit të emetimeve të ndotësve të ajrit;

c) përmirësimit të performancës funksionale dhe të sigurisë së pajisjeve;

ç) orientimit të prodhuesve drejt inovacionit dhe teknologjive të qëndrueshme.

II. FUSHA E ZBATIMIT

1. Ky vendim përcakton kërkesat e projektimit ekologjik për vendosjen në treg dhe vënien në shërbim të pajisjeve të ngrohjes lokale me lëndë djegëse të ngurtë, me prodhim nominal të nxehtësisë deri në 50 kw.

2. Ky vendim nuk zbatohet për:

a) pajisjet e ngrohjes lokale me lëndë djegëse të ngurtë, të përcaktuara vetëm për djegien e biomasës jodrusore;

b) pajisjet e ngrohjes lokale me lëndë djegëse të ngurtë, të përcaktuara vetëm për përdorim në ambient të jashtëm;

c) pajisjet e ngrohjes lokale me lëndë djegëse të ngurtë, tek të cilat prodhimi i drejtpërdrejtë i nxehtësisë është më pak se 6 % e prodhimit të kombinuar të nxehtësisë direkte dhe të tërthortë në prodhimin nominal të nxehtësisë;

ç) pajisjet e ngrohjes lokale me lëndë djegëse të ngurtë, të cilat nuk janë të montuara në fabrikë ose nuk ofrohen si komponentë, ose pjesë të parafabrikuara nga një prodhues i vetëm për t'u montuar në vend;

d) produktet për ngrohjen e ajrit;

dh) pajisjet e ngrohjes për sauna.

III. PËRKUFIZIMET

Për qëllim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. "Biomasë jodrusore", çdo lloj biomase, përveç asaj drusore, përfshirë, ndër të tjera, kashtën, barërat e egra, kallamishtet, kokrrat, drithërat, ullinjtë, pastën nga ullinjtë dhe lëvozhgat e arrave.

2. "Biomasë drusore", biomasa me origjinë nga pemët, shkurret dhe gëmushat, duke përfshirë

[1] Ky vendim është përafruar plotësisht me rregulloren e Komisionit (BE) 2015/1185, e datës 24 prill 2015, për zbatimin e direktivës 2009/125/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me kërkesat e projektimit ekologjik për pajisje të ngrohjes lokale me lëndë djegëse të ngurtë. Numri CELEX 32015R1185, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 193, datë 21.7.2015, f. 1–19.

drurët në copa, drurin e copëtuar, drurin e kompresuar në formë peletesh, drurin e kompresuar në formë briketash dhe tallashin.

3. "Biomasë tjetër drusore", biomasa drusore e ndryshme nga druri në copa me përmbajtje lagështie 25 % ose më pak, lëndët djegëse të kompresuara në formë briketash me përmbajtje lagështie nën 14 %, ose druri i kompresuar me përmbajtje lagështie nën 12 %;

4. "Biomasë", fraksioni i biodegradueshëm i produkteve, mbetjeve dhe mbetjeve me natyrë biologjike nga bujqësia (duke përfshirë substancat bimore dhe shtazore), të pylltarisë dhe industrive të lidhura me to dhe, gjithashtu, nga peshkimi e akuakultura, si dhe fraksionet e biodegradueshme të mbetjeve industriale e komunale.

5. "Dy faza" nënkupton që produkti është në gjendje të rregullojë automatikisht prodhimin e tij të nxehtësisë në dy nivele të dallueshme, në lidhje me temperaturën aktuale të ajrit të brendshëm dhe temperaturën e dëshiruar të ajrit të brendshëm, e kontrolluar përmes pajisjeve të ndjeshmërisë së temperaturës dhe një ndërfaqeje që nuk është domosdoshmërish e integruar në vetë produktin.

6. "E destinuar për përdorim të jashtëm" tregon që produkti është i përshtatshëm dhe i sigurt për t'u përdorur jashtë hapësirave të brendshme, duke përfshirë përdorimin në ambiente të jashtme, të tilla si hapësira të ekspozuara ndaj kushteve të motit, si dielli, shiu etj.

7. "Eficienca sezonale e energjisë për ngrohjen e hapësirës" (ηs) tregon raportin midis kërkesës për ngrohjen e hapësirës, të furnizuar nga një pajisje ngrohëse lokale me lëndë djegëse të ngurtë dhe konsumit vjetor të energjisë, të nevojshëm për të përmbushur këtë kërkesë, e cila shprehet në %.

8. "Emetime të komponimeve organike të gazta", emetimet e komponimeve organike të gazta në prodhimin maksimal të nxehtësisë, të shprehura në mgC/m^3 të gazrave të tymit. E llogaritur në 273 K dhe 1013 mbar me 13 % O_2.

9. "Emetime të materialit grimcor", emetimet e lëndës grimcore në prodhim maksimal të nxehtësisë, të shprehura në mg/m^3 të gazrave të tymit të thatë, të llogaritura në 273 K dhe 1013 mbar me 13 % O_2, ose mesataren e ponderuar të emetimeve të lëndës grimcore deri në katër shpejtësi djegieje, të shprehur në g/kg, lëndë e thatë.

10. "Emetime të monoksidit të karbonit", emetimet e monoksidit të karbonit në prodhimin maksimal të nxehtësisë, të shprehura në mg/m^3 të gazrave të tymit, të llogaritura në 273 K dhe 1013 mbar me 13 % O_2.

11. "Emetime të oksideve të azotit", emetimet e oksideve të azotit në prodhimin maksimal të nxehtësisë, të shprehura në mg/m^3 të gazrave të tymit, të shprehur si NO_2. E llogaritur në 273 K dhe 1013 mbar me 13 % O_2.

12. "Fazë e vetme", produkti, i cili nuk është në gjendje të ndryshojë automatikisht prodhimin e tij të nxehtësisë.

13. "Funksioni i ngrohjes indirekte", aftësia që produkti të transferojë një pjesë të prodhimit total të nxehtësisë në një fluid transmetues nxehtësie, për përdorime si ngrohja e ambienteve ose prodhimi i ujit të ngrohtë për përdorime shtëpiake.

14. "Gjendje e gatishmërisë", gjendja ku pajisja është e lidhur me burimin kryesor të energjisë dhe është në pritje për të funksionuar sipas qëllimit të saj të përcaktuar. Ajo ka mundësinë të sigurojë vetëm funksionet e mëposhtme, të cilat mund të vazhdojnë për një periudhë të pacaktuar kohore: Funksioni i riaktivizimit: Pajisja mund të riaktivizohet dhe të fillojë të funksionojë pas një komande ose sinjali; Funksioni i riaktivizimit me tregues: Pajisja mund të shfaqë një tregues vizual ose sinjal që tregon se është e gatshme për t'u riaktivizuar.

15. "Identifikues i modelit", një kod, zakonisht alfanumerik, që përdoret për të dalluar një model specifik të një pajisjeje ngrohëse nga modelet e tjera të së njëjtës markë, emër furnizuesi dhe tregtari.

16. "Kërkesë e treguesit të ndezjes (ppilot)" i referohet konsumit të lëndës djegëse në formë të gaztë, të lëngshme ose të ngurtë që përdoret për të siguruar një burim ndezjeje, i cili shërben për të filluar procesin e djegies dhe për të prodhuar nxehtësinë maksimale ose të pjesshme, kur ndizet për më shumë se 5 minuta, para se të ndizet djegësi kryesor. Ky konsum shprehet në kw.

17. "Kërkesë për energji elektrike në gjendje gatishmërie (elsb)" sasia e energjisë elektrike që një pajisje, sistem ose produkt konsumon kur ndodhet në gjendje gatishmërie, kur është i ndezur dhe i gatshëm për të filluar punën, por ende nuk është në funksion ndezur. Ky konsum shprehet në kilovat (kw) dhe tregon energjinë e përdorur për të mbajtur pajisjen ose sistemin në gatishmëri për përdorim të ardhshëm.

18. "Kërkesë për energji elektrike në prodhimin maksimal të nxehtësisë (elmax)" konsumi i energjisë

elektrike nga një pajisje e ngrohjes lokale për të siguruar prodhimin e nxehtësisë në nivelin e tij maksimal, pra kur funksionon në kapacitetin e plotë të kërkuar për ngrohje. Konsumi i energjisë elektrike përcaktohet pa marrë në konsideratë energjinë e konsumuar nga qarku elektrik nëse produkti ofron funksionalitete indirekte ngrohëse dhe përfshin, gjithashtu, një qark elektrik të integruar, i shprehur në kw.

19. "Kërkesë për energji elektrike në prodhimin minimal të nxehtësisë (elmin)" konsumi i energjisë elektrike të një pajisjeje të ngrohjes lokale për të siguruar prodhimin e minimumit të kërkuar të nxehtësisë. Konsumi i energjisë elektrike përcaktohet pa marrë parasysh konsumimin e energjisë nga ndonjë komponent tjetër i pajisjes, si për shembull, një qark elektrik që mund të ofrojë funksionalitet të tërthortë ngrohjeje, i shprehur në kw.

20. "Koeficienti i konvertimit" (CC) faktori që reflekton vlerësimin e rendimentit mesatar prej 40%. Vlera e koeficientit të konvertimit është CC = 2.5 (do të thotë një koeficient që pasqyron rendimentin mesatar të prodhimit prej 40% të gjeneratës së BE-së, referuar direktivës 2012/27/EU të Këshillit dhe Parlamentit Evropian).

21. "Lëndë djegëse e ngurtë", një material që është në gjendje të ngurtë në kushte të zakonshme, përfshirë biomasën dhe lëndët djegëse fosile.

22. "Lëndë djegëse e preferuar", lënda djegëse që rekomandohet të përdoret për pajisjet e ngrohjes lokale, sipas udhëzimeve dhe specifikimeve të furnizuesve të pajisjeve të ngrohjes lokale.

23. "Lëndë djegëse fosile e ngurtë", lëndët djegëse të ngurta, përveç lëndëve djegëse nga biomasa, duke përfshirë antracitet, qymyrin me avull të thatë, qymyrin bituminoz, linjitin, ziftin me temperaturë të ulët, si dhe një përzierje të lëndëve djegëse fosile ose një përzierje të biomasës me lëndë djegëse fosile. Për qëllimet e këtij vendimi, përfshihet, gjithashtu, plehu.

24. "Lëndë djegëse të tjera fosile", lëndët fosile që nuk përfshijnë antracitin, qymyrin me avull të thatë, ziftin e fortë, ziftin me temperaturë të ulët, qymyrin bituminoz, linjitët ose briketat dhe pastat e përziera me lëndë djegëse fosile.

25. "Lëndë djegëse të tjera të përshtatshme", lëndët djegëse të ndryshme nga lënda djegëse e preferuar, të cilat mund të përdoren për pajisjet e ngrohjes lokale, sipas udhëzimeve të furnizuesve të pajisjeve. Kjo përfshin çdo lëndë djegëse të përmendur në manualet e udhëzimeve për instaluesit dhe përdoruesit përfundimtarë, duke përfshirë informacionet e disponueshme në faqet zyrtare të internetit dhe materialet promocionale teknike dhe reklamat.

26. "Lëndë grimcore", grimca me forma, struktura dhe dendësi të ndryshme, të shpërndara në fazën e gaztë të tymit të oxhakut.

27. "Model ekuivalent", një model i hedhur në treg me të njëjtat parametra teknikë të përcaktuar në tabelën 1, të pikës 3, të shtojcës I, si një model tjetër i hedhur në treg nga i njëjti prodhues.

28. "Moduluese" nënkupton që produkti është në gjendje të rregullojë automatikisht prodhimin e tij të nxehtësisë në tre ose më shumë nivele të dallueshme, në lidhje me temperaturën aktuale të ajrit të brendshëm dhe temperaturën e dëshiruar të ajrit të brendshëm, e kontrolluar përmes pajisjeve të ndjeshmërisë së temperaturës dhe një ndërfaqeje që nuk është domosdoshmërish e integruar në vetë produktin.

29. "Opsion i kontrollit në distancë", mundësia për të menaxhuar produktin përmes ndërveprimit në distancë, pa praninë fizike të përdoruesit jashtë ndërtesës ku është instaluar produkti.

30. "Opsion i kontrollit të temperaturës, me mbikëqyrje" nënkupton që produkti është i pajisur me një pajisje elektronike, të integruar ose të jashtme, që automatikisht ul temperaturën deri në një nivel të caktuar, pa ndërhyrjen e përdoruesit.

31. "Opsion i kontrollit të temperaturës, i cili përfshin një sensor për dritaren e hapur", do të thotë që produkti është i pajisur me një sistem elektronik, të integruar ose të jashtëm, që ul prodhimin e nxehtësisë kur dritarja ose dera është e hapur. Sensorët përdoren për të zbuluar hapjen e një dritareje ose dere dhe mund të instalohen brenda ose jashtë produktit, duke u integruar në strukturën e tij ose si një kombinim i të dyjave.

32. "Pajisje ngrohëse me djegie të hapur", një pajisje ngrohëse që përdor lëndë djegëse në formë të gaztë, të lëngët ose të ngurtë, ku nxehtësia dhe gazet e djegies nuk shpërndahen jashtë hapësirës ku ndodhet pajisja. Kjo pajisje lidhet me një oxhak, vatër zjarri ose tubacion ventilimi, të cilët shërbejnë për largimin e produkteve të krijuara gjatë djegies.

33. "Pajisje ngrohëse me djegie të mbyllur", një pajisje ngrohëse lokale që përdor lëndë djegëse në formë të gaztë, të lëngët ose të ngurtë, ku procesi i

djegies dhe gazet e krijuara gjatë tij janë të izoluara nga hapësira ku është vendosur pajisja. Kjo pajisje është e lidhur me një oxhak, vatër zjarri ose tubacion ventilimi, që shërben për largimin e produkteve të djegies jashtë mjedisit të brendshëm.

34. "Pajisje ngrohëse me lëndë djegëse të ngurtë i hapur me oxhak, një pajisje ngrohëse me lëndë djegëse të ngurtë, e destinuar të vendoset nën një oxhak ose brenda një oxhaku pa vulosje midis produktit dhe hapjes së oxhakut ose oxhakut të furrës dhe që lejon kalimin e produkteve të djegies pa pengesa nga shtrati i zjarrit drejt oxhakut ose kanalit të tymit.

35. "Pajisje ngrohëse me lëndë djegëse të ngurtë pa oxhak", një pajisje ngrohëse me lëndë djegëse të ngurtë që lëshon produktet e djegies në hapësirën ku ndodhet produkti.

36. "Pajisje ngrohëse që përdorin lëndë djegëse të ngurta", një pajisje ngrohëse që funksionon përmes djegies së lëndëve djegëse të ngurta, si druri, qymyri, peleti dhe materiale të tjera organike të ngurta. Këto pajisje mund të kenë djegie të hapur (si sobat tradicionale ose oxhakët) ose të mbyllur (si furrat moderne me djegie të kontrolluar) dhe përdoren për ngrohjen e hapësirave, shpesh duke ofruar një burim energjie eficient dhe ekonomik për ambiente të ndryshme.

37. "Përmbajtje e lagështisë", sasia e ujit që ndodhet në një lëndë djegëse në lidhje me masën totale të saj. Ky tregues është i rëndësishëm për pajisjet e ngrohjes lokale, pasi sasia e ujit në lëndën djegëse ndikon në eficiencën e djegies.

38. "Prodhim i drejtpërdrejtë i nxehtësisë", procesi i prodhimit të nxehtësisë nga pajisja përmes rrezatimit dhe konveksionit të nxehtësisë, ashtu siç emetohet drejtpërdrejt nga pajisja në ajër, pa përdorur një medium të jashtëm për transmetimin e nxehtësisë. Ky proces është i shprehur në kw dhe tregon sasinë e nxehtësisë që prodhohet nga pajisja në një periudhë të caktuar kohe.

39. "Prodhim i nxehtësisë me dy ose më shumë faza manuale, pa kontroll të temperaturës", nënkupton që produkti ka aftësinë të ndryshojë manualisht nivelin e prodhimit të nxehtësisë në dy ose më shumë faza. Ai nuk është i pajisur me një sistem automatik që rregullon prodhimin e nxehtësisë në bazë të një temperature të caktuar të ambientit.

40. "Prodhim i nxehtësisë me kontroll elektronik të temperaturës së dhomës" nënkupton që produkti është i pajisur me një pajisje elektronike të integruar ose të jashtme, që i lejon produktit të ndryshojë automatikisht prodhimin e tij të nxehtësisë gjatë një periudhe të caktuar, në lidhje me një nivel të caktuar të komoditetit të ngrohjes së brendshme.

41. "Prodhim i nxehtësisë me kontroll elektronik të temperaturës së dhomës plus kohëmatës ditor" nënkupton që produkti është i pajisur me një pajisje elektronike të integruar ose të jashtme dhe që i lejon produktit të ndryshojë automatikisht prodhimin e tij të nxehtësisë gjatë një periudhe të caktuar, në lidhje me një nivel të caktuar të komoditetit të ngrohjes së brendshme dhe lejon vendosjen e kohës dhe nivelit të temperaturës për një interval kohor prej 24 orësh.

42. "Prodhim i nxehtësisë me kontroll elektronik të temperaturës së dhomës plus kohëmatës javor" nënkupton që produkti është i pajisur me një pajisje elektronike të integruar ose të jashtme, që i lejon produktit të ndryshojë automatikisht prodhimin e tij të nxehtësisë gjatë një periudhe të caktuar kohore, në lidhje me një nivel të caktuar të komoditetit të ngrohjes së brendshme dhe lejon vendosjen e niveleve të kohës dhe niveleve të temperaturës për një javë të plotë. Gjatë periudhës 7-ditore, parametrat duhet të lejojnë ndryshime ditë pas dite.

43. "Prodhim i nxehtësisë me kontroll mekanik të temperaturës së dhomës" nënkupton që produkti është i pajisur me një pajisje joelektronike që i lejon produktit të ndryshojë automatikisht fuqinë e tij të nxehtësisë gjatë një periudhe të caktuar, në lidhje me një nivel të caktuar të komoditetit të ngrohjes së brendshme.

44. "Prodhim i nxehtësisë në një fazë të vetme, pa kontroll të temperaturës" nënkupton që produkti nuk është i aftë të rregullojë automatikisht prodhimin e tij të nxehtësisë dhe se nuk ka asnjë mekanizëm të brendshëm për monitorimin apo përshtatjen e temperaturës përmes një sistemi *feedback*.

45. "Prodhim i tërthortë i nxehtësisë" tregon prodhimin e nxehtësisë nga një pajisje, përmes përdorimit të një fluidi transmetues të nxehtësisë, i cili kalon nëpër një proces që siguron prodhimin e drejtpërdrejtë të nxehtësisë për produktin. Ky proces ndodh si një efekt anësor dhe nxehtësia e prodhuar në këtë mënyrë matet në kilovat (kw).

46. "Prodhim maksimal i nxehtësisë (Pmax)", prodhim i nxehtësisë nga një pajisje ngrohëse lokale, që përfshin si prodhimin e drejtpërdrejtë të nxehtësisë ashtu edhe prodhimin e tërthortë të

nxehtësisë (kur është e aplikueshme), kur pajisja funksionon në kapacitetin e saj maksimal të prodhimit të nxehtësisë, siç është përcaktuar nga prodhuesi, e shprehur në kw.

47. "Prodhim minimal i nxehtësisë (Pmin)" sasia e nxehtësisë që prodhon një pajisje ngrohëse lokale, përfshirë si prodhimin e nxehtësisë së drejtpërdrejtë, ashtu edhe prodhimin e nxehtësisë së tërthortë (kur është e aplikueshme), kur operon duke realizuar nivelin minimal të prodhimit të nxehtësisë, siç është përcaktuar nga prodhuesi, e shprehur në kw.

48. "Produkt për ngrohjen e ajrit", një produkt që ofron ngrohje për një pajisje ngrohjeje me bazë ajri dhe mund të jetë i pajisur me kanale ajri. Ky produkt është projektuar për t'u përdorur i fiksuar ose i siguruar në një vend specifik ose i montuar në mur dhe shpërndan ajrin nëpërmjet një pajisjeje për lëvizjen e ajrit, me qëllim arritjen dhe mirëmbajtjen e një niveli të caktuar të rehatisë termike për njerëzit brenda një hapësire të mbyllur ku ndodhet produkti.

49. "Rendiment i dobishëm në prodhimin maksimal ose minimal të nxehtësisë (ηth, nom ose ηth, min), raporti ndërmjet energjisë së dobishme të nxehtësisë të prodhuar dhe energjisë totale të hyrjes, e shprehur në terma të NCV (vlera kalorifike neto), të një sistemi ngrohës dhe është shprehur në përqindje (%).

50. "Sobë saune" një pajisje ngrohëse lokale me lëndë djegëse të ngurtë, e përfshirë në ose e deklaruar për t'u përdorur në sauna të thata ose të lagështa ose mjedise të ngjashme.

51. "Sobë", një pajisje ngrohëse që përdor lëndë djegëse të ngurta, i cili kryen dy funksione njëkohësisht: atë të ngrohësit dhe të furrës për gatim. Ajo është e lidhur me një oxhak, vatër zjarri ose një sistem ventilimi që mundëson largimin e produkteve të djegies, si tymi dhe gazrat, nga ambienti ku ndodhet soba.

52. "Vlera kalorifike neto (NCV)", sasia e energjisë që çlirohet kur një material digjet plotësisht me oksigjen dhe produktet e djegies (përfshirë avullin e ujit) nuk rikthehen në temperaturën e ambientit. Ky është procesi që ndodh kur uji që krijohet gjatë djegies mbetet në formën e avullit dhe nuk kondensohet për t'u kthyer në ujë. Në këtë rast, energjia, që humbet gjatë kondensimit të avullit, nuk merret parasysh, pasi nuk mund të shfrytëzohet për qëllime ngrohjeje.

IV. KËRKESAT E PROJEKTIMIT EKOLOGJIK DHE AFATET KOHORE

1. Kërkesat e projektimit ekologjik për pajisjet ngrohëse lokale me lëndë djegëse të ngurtë janë të përcaktuara në shtojcën I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pajisjet ngrohëse lokale me lëndë djegëse të ngurtë duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara në shtojcën I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Përputhshmëria me kërkesat e projektimit ekologjik matet dhe llogaritet në përputhje me metodat e përcaktuara në shtojcën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

V. VLERËSIMI I KONFORMITETIT

1. Procedura e vlerësimit të konformitetit, e përmendur në pikën 4, të nenit 7/1, të ligjit nr. 52/2024,"Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", të ndryshuar, realizohet në përputhje me parashikimet e akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe me përcaktimet e nenit 23, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore".

2. Për qëllime të vlerësimit të konformitetit, sipas pikës 4, të nenit 7/1, të ligjit nr. 52/2024,"Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", të ndryshuar, dokumentacioni teknik duhet të përmbajë informacionin e përcaktuar në pikën 3, të shtojcës I, të këtij vendimi.

3. Kur informacioni i përfshirë në dokumentacionin teknik të një modeli është përfituar nëpërmjet llogaritjeve mbi bazën e projektimit ose përmes ekstrapolimit nga modele të tjera ose të dyjave së bashku, dokumentacioni teknik përmban hollësitë përkatëse mbi këto llogaritje ose ekstrapolime, si dhe testet e kryera nga prodhuesi për verifikimin e saktësisë së tyre. Në këto raste, dokumentacioni teknik duhet të përfshijë, gjithashtu, listën e modeleve që kanë shërbyer si bazë për ekstrapolim, si dhe të të gjitha modeleve të tjera për të cilat informacioni është përfituar mbi të njëjtën bazë.

VI. TREGUESIT ORIENTUES

Treguesit orientues për pajisjet e ngrohjes lokale me lëndë djegëse të ngurtë, të cilat kanë performancën më të mirë të disponueshme në treg në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, janë përcaktuar në shtojcën IV, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

VII. DISPOZITË TRANZITORE

Në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ky vendim shfuqizohet.

VIII. HYRJA NË FUQI

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA I
KËRKESAT E PROJEKTIMIT EKOLOGJIK

1. Kërkesat specifike të projektimit ekologjik për eficiencën sezonale të ngrohjes së hapësirës:

a) Pajisjet ngrohëse lokale me lëndë djegëse të ngurtë duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

i. Eficienca energjetike e ngrohjes sezonale të pajisjeve ngrohëse lokale me lëndë djegëse të ngurtë me djegie të hapur nuk duhet të jetë më pak se 30 %;

ii. Eficienca energjetike e ngrohjes sezonale të hapësirës së pajisjeve ngrohëse lokale me lëndë djegëse të ngurtë me djegie të mbyllur, që përdorin lëndë djegëse të ngurtë, përveç drurit të kompresuar në formë kokrrizore, nuk duhet të jetë më pak se 65 %;

iii. Eficienca energjetike e ngrohjes sezonale të pajisjeve ngrohëse lokale me lëndë djegëse të ngurtë me djegie të mbyllur, që përdorin drurë të kompresuar në formë kokrrizore nuk duhet të jetë më pak se 79 %;

iv. Eficienca energjetike e ngrohjes sezonale e pajisjeve ngrohëse lokale si soba nuk duhet të jetë më pak se 65%.

2. Kërkesa specifike të projektimit ekologjik për emetimet:

a) Emetimet e lëndës grimcore (PM) nga pajisjet ngrohëse lokale me lëndë djegëse të ngurtë nuk duhet të tejkalojnë vlerat e mëposhtme:

i. Emetimet e lëndës grimcore (PM) nga pajisjet ngrohëse lokale me lëndë djegëse të ngurtë me djegie të hapur nuk duhet të tejkalojnë 50 mg/m³ me 13 % O_2 kur matet sipas metodës së përshkruar në shtojcën II, pika 4, shkronja "a", nënndarja "i", paragrafi 1, ose 6 g/kg (lëndë e thatë) kur matet sipas metodës së përshkruar në shtojcën II, pika 4, shkronja "a", nënndarja "i", paragrafi 2;

ii. Emetimet e lëndës grimcore (PM) nga pajisjet ngrohëse lokale me lëndë djegëse të ngurtë me djegie të mbyllur, që përdorin lëndë djegëse të ngurtë, përveç drurit të kompresuar në formë kokrrizore, si dhe sobat nuk duhet të tejkalojnë 40 mg/m³ me 13 % O_2 kur matet sipas metodës së përshkruar në shtojcën II, pika 4, shkronja "a", nënndarja "i", paragrafi (1), ose 5 g/kg (lëndë e thatë) kur matet sipas metodës së përshkruar në shtojcën II, pika 4, shkronja "a", nënndarja "i", paragrafi 2, ose 2,4 g/kg (lëndë e thatë) për biomasën, ose 5,0 g/kg (lëndë e thatë) për lëndë djegëse fosile të ngurta kur matet sipas metodës së përshkruar në shtojcën II, pika 4, shkronja "a", nënndarja "i", paragrafi 3;

iii. Emetimet e lëndës grimcore (PM) nga pajisjet ngrohëse lokale me lëndë djegëse të ngurtë me djegie të mbyllur, që përdorin drurë të kompresuar në formë kokrrizore, nuk duhet të tejkalojnë 20 mg/m³ me 13 % O_2 kur matet sipas metodës së përshkruar në shtojcën II, pika 4, shkronja "a", nënndarja "i", 1, ose 2,5 g/kg (lëndë e thatë) kur matet sipas metodës së përshkruar në shtojcën II, pika 4, shkronja "a", nëndarja "i", paragrafi 2, ose 1,2 g/kg (lëndë e thatë) kur matet sipas metodës së përshkruar në shtojcën II, pika 4, shkronja "a", nënndarja "i", paragrafi 3;

b) Emetimet e përbërjeve organike të gazta (OGC) nga pajisjet ngrohëse lokale me lëndë djegëse të ngurtë nuk duhet të tejkalojnë vlerat e mëposhtme:

i. Emetimet e përbërjeve organike të gazta (OGC) nga pajisjet ngrohëse lokale me lëndë djegëse të ngurtë me djegie të hapur, pajisjet ngrohëse lokale me djegie të mbyllur, që përdorin lëndë djegëse të ngurtë, përveç drurit të kompresuar në formë kokrrizore, si dhe sobat nuk duhet të tejkalojnë 120 mgC/m³ me 13 % O_2;

ii. Emetimet e përbërjeve organike të gazta (OGC) nga pajisjet ngrohëse lokale me lëndë djegëse të ngurtë me djegie të mbyllur, që përdorin drurë të kompresuar në formë kokrrizore, nuk duhet të tejkalojnë 60 mgC/m³ me 13 % O_2.

c) Emetimet e monoksidit të karbonit (CO) nga pajisjet ngrohëse lokale me lëndë djegëse të ngurtë nuk duhet të tejkalojnë vlerat e mëposhtme:

i. Emetimet e monoksidit të karbonit (CO) nga pajisjet ngrohëse lokale me lëndë djegëse të ngurtë me djegie të hapur nuk duhet të tejkalojnë 2 000 mg/m³ me 13 % O_2;

ii. Emetimet e monoksidit të karbonit (CO) nga pajisjet ngrohëse lokale me lëndë djegëse të ngurtë

me djegie të mbyllur, që përdorin lëndë djegëse të ngurtë, përveç drurit të kompresuar në formë kokrre, si dhe sobat nuk duhet të tejkalojnë 1500 mg/m³ me 13 % O_2;

58	492623.6489	4488027.299	**199**	488249.6059	4490824.564	**340**	491075.4279	4489143.262
59	492661.2754	4488080.736	**200**	488294.7876	4490873.7	**341**	491097.1557	4489135.395
60	492647.0709	4488123.892	**201**	488399.7965	4490918.545	**342**	491139.0155	4489117.207
61	492661.9615	4488159.122	**202**	488483.688	4490876.854	**343**	491156.5434	4489054.141
62	492663.135	4488169.514	**203**	488498.5915	4490736.864	**344**	491161.3778	4489046.75
63	492657.9129	4488197.597	**204**	488561.9652	4490722.262	**345**	491203.0519	4488997.224
64	492595.7526	4488231.857	**205**	488661.9294	4490646.256	**346**	491241.3298	4488980.673
65	492631.3498	4488279.717	**206**	488708.3591	4490556.311	**347**	491282.2047	4488945.884
66	492690.9995	4488328.889	**207**	488756.2043	4490517.76	**348**	491282.9008	4488874.537
67	492680.6985	4488375.561	**208**	488771.7219	4490488.589	**349**	491338.8039	4488857.206
68	492742.9763	4488379.456	**209**	488751.4994	4490411.82	**350**	491353.0117	4488811.841
69	492712.4487	4488434.244	**210**	488790.6014	4490363.415	**351**	491418.432	4488769.29
70	492710.523	4488439.676	**211**	488808.9508	4490308.123	**352**	491412.8083	4488857.085
71	492698.8489	4488472.609	**212**	488812.0142	4490276.169	**353**	491395.2528	4488887.181
72	492602.2218	4488482.397	**213**	488789.0417	4490237.094	**354**	491375.4524	4488911.714
73	492595.3616	4488489.371	**214**	488758.7165	4490181.044	**355**	491357.7772	4488951.81
74	492501.2296	4488482.474	**215**	488766.1692	4490178.201	**356**	491377.0466	4488967.101
75	492413.3848	4488446.72	**216**	488785.2399	4490201.656	**357**	491371.1302	4489016.63
76	492336.4441	4488422.379	**217**	488810.2501	4490207.085	**358**	491396.8225	4489054.145
77	492268.9257	4488425.13	**218**	488822.1906	4490235.015	**359**	491448.6838	4489096.741
78	492209.6866	4488471.609	**219**	488835.9858	4490234.996	**360**	491494.6933	4489157.819
79	492148.6484	4488510.428	**220**	488846.4999	4490256.361	**361**	491521.9325	4489206.329
80	492090.6602	4488516.88	**221**	488853.6825	4490267.57	**362**	491571.8452	4489237.941
81	492026.4144	4488526.129	**222**	488877.1445	4490254.561	**363**	491624.0972	4489274.833
82	492041.3864	4488598.256	**223**	488893.0658	4490259.232	**364**	491663.8907	4489346.331
83	492056.6741	4488665.449	**224**	488892.3875	4490284.356	**365**	491694.3431	4489377.437
84	492006.2061	4488766.609	**225**	488907.9787	4490299.069	**366**	491739.0626	4489402.384
85	491877.1826	4488750.146	**226**	488927.7037	4490297.803	**367**	491777.7767	4489420.856

86	491873.3755	4488753.452	**227**	488950.0582	4490296.535	**368**	491818.3072	4489430.721
87	491777.0959	4488771.27	**228**	488966.9027	4490287.91	**369**	491847.9141	4489450.728
88	491729.1971	4488800.555	**229**	488979.6973	4490273.366	**370**	491847.538	4489456.8
89	491690.5628	4488840.818	**230**	488994.2331	4490269.757	**371**	491846.1469	4489493.838
90	491690.5226	4488848.985	**231**	489005.9109	4490251.463	**372**	491867.2631	4489504.297
91	491669.2197	4488917.082	**232**	489020.3905	4490225.115	**373**	491909.2487	4489496.919
92	491668.0864	4488924.416	**233**	489037.4436	4490200.756	**374**	491952.6745	4489495.837
93	491627.0435	4488971.66	**234**	489055.0152	4490184.061	**375**	491972.9941	4489531.846
94	491585.6876	4488995.809	**235**	489068.4708	4490154.366	**376**	491996.6531	4489572.172
95	491535.9514	4488981.851	**236**	489076.8309	4490132.27	**377**	492034.7155	4489564.415
96	491531.676	4488981.855	**237**	489086.4177	4490120.015	**378**	492071.1972	4489538.226
97	491479.9468	4488988.251	**238**	489106.4853	4490110.826	**379**	492110.7397	4489539.273
98	491508.7018	4488936.852	**239**	489100.6283	4490112.753	**380**	492156.6614	4489572.044
99	491537.5723	4488888.191	**240**	489118.5514	4490092.14	**381**	492200.9227	4489566.485
100	491567.3366	4488824.719	**241**	489139.8301	4490060.808	**382**	492226.6985	4489610.161
101	491594.4439	4488750.41	**242**	489158.3706	4490039.949	**383**	492243.4607	4489629.641
102	491647.1646	4488700.586	**243**	489165.2021	4490011.185	**384**	492287.3048	4489621.548
103	491685.8911	4488624.719	**244**	489156.0076	4489993.972	**385**	492330.7608	4489612.36
104	491720.9399	4488561.201	**245**	489153.1538	4489992.802	**386**	492362.6672	4489655.196
105	491752.5525	4488548.6	**246**	489130.9715	4489980.615	**387**	492367.32	4489676.531
106	491757.1108	4488542.83	**247**	489109.6282	4489961.27	**388**	492404.0953	4489683.69
107	491798.3774	4488495.61	**248**	489100.7925	4489949.56	**389**	492444.7599	4489689.677
108	491829.9202	4488484.48	**249**	489121.5423	4489950.085	**390**	492482.9743	4489657.463
109	491806.4635	4488465.287	**250**	489123.1803	4489950.083	**391**	492515.3575	4489614.505
110	491750.1176	4488450.874	**251**	489139.2693	4489958.981	**392**	492517.1791	4489565.801
111	491683.9031	4488511.595	**252**	489151.6961	4489953.376	**393**	492500.7994	4489485.584
112	491674.2782	4488550.605	**253**	489158.3032	4489941.218	**394**	492501.1232	4489482.52
113	491669.5327	4488557.373	**254**	489177.8916	4489930.345	**395**	492532.7378	4489455.983
114	491618.3856	4488580.852	**255**	489193.6245	4489932.021	**396**	492534.3688	4489455.982
115	491567.4156	4488603.706	**256**	489214.4544	4489907.704	**397**	492576.2192	4489447.679
116	491532.4806	4488650.414	**257**	489231.4069	4489880.803	**398**	492601.0511	4489448.836
117	491476.013	4488723.275	**258**	489239.9711	4489853.131	**399**	492634.2259	4489444.113
118	491350.6875	4488776.135	**259**	489252.1856	4489828.557	**400**	492636.386	4489444.111
119	491303.7944	4488758.403	**260**	489261.4255	4489799.515	**401**	492679.4754	4489470.229
120	491249.3292	4488741.971	**261**	489262.263	4489774.267	**402**	492709.6692	4489473.228
121	491198.5264	4488730.069	**262**	489257.5057	4489749.755	**403**	492751.7621	4489438.767
122	491187.4442	4488730.081	**263**	489280.1203	4489761.544	**404**	492753.2651	4489381.936
123	491113.6597	4488689.11	**264**	489298.4398	4489751.773	**405**	492796.1725	4489359.5
124	491059.5182	4488648.205	**265**	489322.3077	4489734.614	**406**	492834.1205	4489354.781
125	491030.0464	4488602.376	**266**	489334.312	4489710.54	**407**	492860.4613	4489306.801
126	490991.477	4488523.443	**267**	489345.2724	4489694.223	**408**	492861.6839	4489304.574
127	491006.1312	4488466.713	**268**	489346.8864	4489691.643	**409**	492886.1679	4489251.22
128	490893.6577	4488395.383	**269**	489363.2315	4489679.486	**410**	492924.4534	4489268.163
129	490796.9685	4488439.7	**270**	489381.3974	4489664.39	**411**	492961.7821	4489264.573

130	490723.9125	4488491.297	**271**	489400.5849	4489651.407	**412**	492984.2559	4489243.464
131	490613.0971	4488618.299	**272**	489411.1342	4489678.154	**413**	493013.4207	4489251.12
132	490549.9288	4488722.801	**273**	489430.3161	4489689.602	**414**	493039.975	4489257.43
133	490450.6914	4488865.417	**274**	489461.4081	4489685.717	**415**	493074.0686	4489248.973
134	490467.9803	4488900.533	**275**	489448.2803	4489629.614	**416**	493087.3969	4489253.871
135	490542.2899	4488942.977	**276**	489451.1603	4489597.546	**417**	493125.579	4489271.738
136	490647.7943	4489018.285	**277**	489479.208	4489583.896	**418**	493146.5566	4489288.92
137	490604.8035	4489123.482	**278**	489497.4833	4489595.394	**419**	493169.607	4489307.706
138	490541.8544	4489283.703	**279**	489536.6661	4489597.925	**420**	493200.9156	4489309.421
139	490477.5534	4489315.405	**280**	489556.6927	4489581.255	**421**	493220.5866	4489298.492
140	490390.7963	4489303.039	**281**	489622.1216	4489550.656	**422**	493224.1201	4489299.06
141	490323.056	4489294.861	**282**	489638.8158	4489494.674			



Zona 18 Njësia Administrative Aranitas								
Nr.	**Koordinata X**	**Koordinata Y**	**Nr.**	**Koordinata X**	**Koordinata Y**	**Nr.**	**Koordinata X**	**Koordinata Y**
1	483005.7105	4495444.143	**17**	482369.0778	4494826.532	**33**	482625.3663	4495333.095
2	483080.4198	4495384.005	**18**	482330.0792	4494841.047	**34**	482659.2284	4495347.317
3	483091.4091	4495258.781	**19**	482297.3204	4494839.355	**35**	482682.3575	4495336.852
4	483096.2634	4495179.259	**20**	482315.5472	4494872.794	**36**	482719.7867	4495310.89
5	483126.3289	4495082.733	**21**	482333.0471	4494884.575	**37**	482778.0851	4495337.691
6	483122.6856	4494983.671	**22**	482358.6597	4494941.849	**38**	482809.227	4495341.869
7	483013.4007	4494732.738	**23**	482376.257	4494962.019	**39**	482844.9352	4495331.228
8	482755.9714	4494580.336	**24**	482414.9966	4494990.689	**40**	482878.617	4495360.074
9	482616.3204	4494559.33	**25**	482471.885	4495037.073	**41**	482871.7006	4495390.785
10	482554.9114	4494583.974	**26**	482500.3061	4495071.801	**42**	482855.3547	4495438.137
11	482526.1506	4494604.675	**27**	482509.8435	4495099.575	**43**	482806.9485	4495489.237
12	482503.9909	4494644.602	**28**	482521.341	4495165.519	**44**	482839.7022	4495536.021
13	482433.995	4494681.242	**29**	482538.4372	4495203.941	**45**	482869.3628	4495561.418
14	482409.2631	4494779.108	**30**	482560.5781	4495243.451	**46**	482935.043	4495576.013
15	482409.2057	4494796.597	**31**	482594.6898	4495258.771	**47**	483005.7105	4495444.143
16	482393.9652	4494812.457	**32**	482599.3493	4495305.908			


ZONA ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E EKONOMISË MALORE
ZONA 19, NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR DUKAS, BASHKIA MALLAKASTËR, QARKU FIER
AKPT
AGENSIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
amvv
BASHKIA MALLAKASTËR
Njësia Administrative | Zona | Sipërfaqe (ha)
Hekal | Zona 1 | 79
Kutë dhe Fratar | Zona 2 | 174
Kutë | Zona 3 | 367
Qendër Dukas, Aranitas dhe Ngraçan | Zona 4 | 714
Fratar | Zona 5 | 234
Kutë | Zona 6 | 166
Kutë | Zona 7 | 71
Aranitas | Zona 8 | 3
Selitë | Zona 9 | 45
Aranitas | Zona 10 | 72
Aranitas | Zona 11 | 71
Qendër Dukas | Zona 12 | 32
Qendër Dukas | Zona 13 | 453
Kutë | Zona 14 | 5
Kutë | Zona 15 | 7
Hekal | Zona 16 | 125
Selitë | Zona 17 | 357
Aranitas | Zona 18 | 48
Qendër Dukas | Zona 19 | 18
Qendër Dukas | Zona 20 | 1
1:5,000
0 0 0.1 0.2 0.2 0.3 km
Legjendë
Zona me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore
Bashkia Mallakastër
Ndërtesa
Izolipse
Kategoritë e Rrjetit Rrugor
Kategoria C. Rruge Interurbane Dytesore
Kategoria F. Rruge Lokale
*Zona 19 ndodhet në territorin e Njësisë Administrative Qendër Dukas, me sipërfaqe prej 18 ha
**Sistemi Koordinativ KRGJSH (Korniza Referuese Gjeodezike Shqiptare) EPSG 6870
Zona 19
Sh4 e Vjeter
Sh4 e Vjeter
Map data © OpenStreetMap contributors, Microsoft, Facebook, Google, Esri Community Maps contributors, Map layer by Esri
479000
480000
4494000

Zona 19 Njësia Administrative Qendër Dukas		
Nr.	Koordinata X	Koordinata Y
1	479179.0315	4494264.042
2	479197.4953	4494298.617
3	479224.3942	4494310.541
4	479249.9633	4494300.641
5	479340.0052	4494399.059
6	479363.9576	4494464.025
7	479411.5264	4494476.606
8	479469.6965	4494432.725
9	479516.0792	4494374.947
10	479511.5194	4494356.002
11	479550.6737	4494304.121
12	479583.6481	4494208.533
13	479615.5956	4494175.933
14	479606.3732	4494116.154
15	479565.6903	4494077.788
16	479494.6032	4494047.995
17	479442.2435	4494010.621
18	479407.4551	4493968.882
19	479376.8833	4493957.412
20	479325.9835	4493933.64
21	479264.5825	4493916.729
22	479215.2205	4493901.775
23	479163.9681	4493911.352
24	479127.1836	4493887.021
25	479099.2209	4493898.355
26	479123.5294	4494059.048
27	479152.3052	4494170.006
28	479179.0315	4494264.042



Zona 20 Njësia Administrative Qendër Dukas		
Nr.	**Koordinata X**	**Koordinata Y**
1	477653.2032	4498470.001
2	477667.81	4498461.77
3	477648.1712	4498398.998
4	477647.5373	4498395.748
5	477628.4882	4498342.682
6	477626.5313	4498342.688
7	477605.0198	4498342.245
8	477587.263	4498345.077
9	477574.8082	4498337.83
10	477574.3418	4498337.583
11	477553.4712	4498309.83
12	477526.9377	4498284.674
13	477526.5802	4498313.065
14	477534.7977	4498347.589
15	477547.1111	4498373.276
16	477551.705	4498388.914
17	477560.1065	4498415.804
18	477573.3604	4498426.698
19	477598.8374	4498453.08
20	477618.0465	4498470.537
21	477641.7117	4498484.608
22	477653.2032	4498470.001

VENDIM
Nr. 54, datë 30.4.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji, kryetare;
Marsida Xhaferllari, anëtare;
Sonila Bejtja, anëtare;
Sandër Beci, anëtar;
Ilir Toska anëtar;
Genti Ibrahimi, anëtar;
Marjana Semini, anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 30.4.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 38 (A) 2025 të Regjistrit Themeltar që u përket:

KËRKUES: Arben Braçe

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Drejtësisë, përfaqësuar nga Xhelal Kasaj dhe Ornela Marku, me autorizim.

Departamenti i Administratës Publike, përfaqësuar nga drejtoresha e departamentit Vilma Guri.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-826 (100), datë 6.3.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Pezullimi i vendimit nr. 00-2025-826 (100), datë 6.3.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 13, 17, 18, 28, 31, 33, 34, 41, 42, 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 6, 6/1, 19 dhe 46, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)* dhe neni 1, i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës).*

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Arben Braçe *(kërkuesi)*, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Ministrisë së Drejtësisë dhe Departamentit të Administratës Publike *(DAP)*, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka qenë pjesë e shërbimit civil dhe së fundmi ka pasur detyrën e drejtorit të përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Çështjeve të Drejtësisë. Me shkresën nr. 413/4 prot., datë 21.10.2013, të ministrit të Drejtësisë kërkuesit i është njoftuar: i. suprimimi i pozicionit të punës në zbatim të urdhrit nr. 188/2013, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Drejtësisë" të Kryeministrit; ii. pamundësia e sistemimit në një tjetër vend pune të të njëjtit nivel ose në nivel tjetër; iii. dalja në listëpritje. Me urdhrin nr. 413/4/1, datë 1.11.2013, të ministrit kërkuesi ka kaluar në listëpritjeje me efekte të menjëhershme financiare.

2. Ndërkohë, Kuvendi, në datën 30.5.2013, ka miratuar ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" (*ligji nr. 152/2013*), i cili parashikonte hyrjen e tij në fuqi në datën 1.10.2013 (*neni 72*), shfuqizimin e ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil" *(ligji nr. 8549/1999)*, si dhe çdo dispozitë tjetër që ishte në kundërshtim me të (*neni 70*). Në vijim, Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ nr. 5, datë 30.9.2013, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 152/2013, 'Për nëpunësin civil'", i cili kishte për qëllim shtyrjen në kohë të efekteve të ligjit nr. 152/2013. Akti normativ ka hyrë në fuqi menjëherë dhe është miratuar nga Kuvendi me ligjin nr. 161/2013, datë 17.10.2013. Këto dy akte janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) me vendimin nr. 5, datë 5.2.2014 (*vendimi nr. 5/2014*), i cili ka hyrë në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare nr. 18, datë 26.2.2014.

3. Në datën 23.10.2014, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke paditur Ministrinë e Drejtësisë e duke thirrur si person të tretë DAP-in me kërkesëpadi, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrit nr. 413/4/1, datë 1.11.2013, të ministrit të Drejtësisë, të shkresës nr. 413/4 prot., datë 21.10.2013, të ministrit të Drejtësisë dhe zgjidhjen e pasojave nëpërmjet sistemimit në një pozicion pune sipas strukturës së re, si edhe pagimin e pagës së plotë nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2967, datë 2.6.2015, ka vendosur: i. pranimin e kërkesëpadisë; ii. konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrit nr. 413/4/1 prot., datë 1.11.2013, të ministrit të Drejtësisë "Për kalimin në listëpritje" të kërkuesit; iii. detyrimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe DAP-it të ripozicionojnë kërkuesin në shërbimin civil, duke e kthyer në vendin e mëparshëm të punës dhe, vetëm në pamundësi, në një pozicion tjetër ekuivalent në Ministrinë e Drejtësisë ose në institucione të tjera, në përputhje me kualifikimet dhe statusin e tij si nëpunës civil; iv. detyrimin e Ministrisë së Drejtësisë t'i paguajë kërkuesit pagën nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në rikthimin e tij në punë.

5. Pas ankimit të DAP-it dhe të Avokaturës së Shtetit, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1805, datë 26.4.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2967, datë 2.6.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Për rekurset e DAP-it, në datën 30.5.2018, dhe të Avokaturës së Shtetit, në datën 6.6.2018, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-826 (100), datë 6.3.2025, ka vendosur ndryshimin e vendimeve nr. 1805, datë 26.4.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe nr. 2967, datë 2.6.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe rrëzimin e padisë.

6. Gjatë kohës që rekursi i subjekteve të interesuara ishte ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë, në datën 6.7.2018, kërkuesi është ftuar nga Ministria e Drejtësisë duke iu komunikuar gatishmëria për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, me kusht që të hiqte dorë nga kërkimi për rikthimin në detyrë. Në lidhje me këtë propozim, në prani të komisionit të posaçëm, në procesverbalin nr. 5113/4, datë 6.7.2018, nga kërkuesi është nënshkruar deklarata përkatëse. Në muajin dhjetor të vitit 2019 kërkuesi e ka marrë dëmshpërblimin e plotë të pagës sipas detyrimit që përcaktonte vendimi gjyqësor.

7. Kërkuesi, në datën 23.7.2025, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë, sipas objektit. Kolegji i Gjykatës, në datën 24.10.2025, gjatë shqyrtimit paraprak, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 10.11.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, si dhe shqyrtimin në seancën plenare

të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Lartë.

8. Në datën 30.4.2026, një gjyqtar i Gjykatës ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendim të po kësaj date, ka vendosur pranimin e kërkesës, duke vlerësuar se gjyqtari gjendej përpara rastit të parashikuar në nenin 36, pika 1, shkronja ç", të Ligjit Organik të Gjykatës dhe nenit 18, pika 1, shkronja "ç", të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar:

9.1 *E drejta për t'u njoftuar, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur,* pasi rekurset e paraqitura nga Avokatura e Shtetit dhe DAP-i nuk i janë komunikuar kërkuesit, duke e vendosur atë në pamundësi për të paraqitur prapësimet e tij. Po kështu, kërkuesit i është mohuar e drejta e ballafaqimit të provave ose e opinioneve me palët e tjera, sepse Kolegji Administrativ ka gjykuar vetëm për pretendimet e palës rekursuese, pa i dhënë mundësi kërkuesit të njihej dhe të shprehej për to. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhej të merrte masat e nevojshme për t'i garantuar kërkuesit të drejtën për të marrë pjesë në gjykim, si dhe të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur nëpërmjet dhënies së mundësisë për të paraqitur parashtrimet e tij, pavarësisht faktit që gjykimi administrativ bëhet, si rregull, në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve. Përkundrazi, ajo është mjaftuar me komunikimin elektronik për kohën e shqyrtimit të çështjes, por nuk i ka njoftuar kërkuesit rekurset e ushtruara nga pala e paditur dhe personi i tretë në gjykim. Kjo, për më tepër kur në përfundim Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e padisë vetëm mbi bazën e pretendimeve të palës tjetër, duke e vendosur kërkuesin tërësisht në një pozitë të pafavorshme. Për këto shkaqe janë cenuar edhe e *drejta për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit) dhe parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit.*

9.2 *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur për themelin e çështjes, duke bërë një vlerësim të ndryshëm të provave dhe të fakteve të administruara gjatë gjykimit në gjykatat më të ulëta. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pavarësisht se nuk ka vënë në dyshim vlerën e provave të paraqitura, ka bërë një vlerësim të ndryshëm të tyre, duke e ndryshuar themelin e çështjes. Nëse Gjykata e Lartë do të kishte dyshime për dijeninë e komunikimit të rekurseve të ushtruara, jo vetëm duhet të administronte edhe prapësimet e kërkuesit, por duhet të kthente çështjen për rishqyrtim në gjykatat e faktit.

9.3 *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor i lidhur me aksesin substancial,* pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka verifikuar me nismën e saj çështjen e vlefshmërisë së ligjit për shërbimin civil. Kur Gjykata e Lartë vë në diskutim çështje të ligjit, të cilat merren në shqyrtim kryesisht dhe për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, përpara shqyrtimit të rekursit urdhërohet njoftimi i palëve dhe caktohet afati për depozitimin e parashtresave të tyre për çështjet e ligjit. Në këto raste, neni 482/a, pika 1, shkronja "b", i Kodit të Procedurës Civile, në harmoni me nenin 62, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), parashikon se Gjykata e Lartë, nëse e vlerëson të nevojshme për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Kërkuesi nuk ka pasur mundësi të paraqesë mendimin e tij për çështjet e ligjit. Në të dyja rekurset e paraqitura nuk është marrë në konsideratë fakti që në datën 6.7.2018, kërkuesi është thirrur dhe i është komunikuar gatishmëria e institucionit për të ekzekutuar vendimin e gjykatës së apelit, duke i bërë me dije njëkohësisht se nëse hiqte dorë nga rikthimi në pozicionin e detyrës që mbante përpara largimit, pjesa e vendimit që kishte të bënte me pjesën ekonomike të dëmshpërblimit do të ekzekutohej menjëherë. Për këtë propozim, në prani të komisionit të posaçëm kërkuesi ka nënshkruar deklaratë duke kërkuar vetëm shpërblimin dhe jo rikthimin në punë.

9.4 *Parimi i barazisë përpara ligjit dhe i mosdiskriminimit,* pasi Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrime të ndryshme në kushte të njëjta objektive kur është kërkuar pavlefshmëria e vendimit për suprimimin e vendit të punës. Ndryshe nga çështja e kërkuesit, në një rast të njëjtë, por një trup tjetër gjykues i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se vendimi i ministrit të Drejtësisë për

kalimin në listëpritje nuk ishte kryer nga personi zyrtar përgjegjës, sikurse ka qenë rasti i shtetasit A. B. Në këtë mënyrë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka zbatuar ligjin në mënyrë të barabartë për të gjithë individët dhe kërkuesi është dëmtuar duke u ligjëruar lirimi i padrejtë i tij nga detyra. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur një standard të dyfishtë në jurisprudencë për ligjin e zbatueshëm për lirimin e nëpunësve civilë gjatë periudhës tranzitore nga datat 1.10.2013–26.2.2014. Ai kolegj ka dështuar në rolin e tij për njësimin ose zhvillimin e jurisprudencës në zbatim të nenit 141 të Kushtetutës. Në praktikën e Gjykatës së Lartë ka paqëndrueshmëri në zbatimin e ligjit, pasi në periudhën nga viti 2015 deri në vitin 2019 është cilësuar si i zbatueshëm ligji nr. 152/2013. Ndërsa pas vitit 2022 në disa raste është vlerësuar si i zbatueshëm ligji nr. 152/2013 dhe herë të tjera ligji nr. 8549/1999. Vendimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor dhe krijon një gjendje pasigurie juridike duke ulur besimin në publik, duke cenuar kështu edhe *parimin e sigurisë juridike*.

9.5 *Standardi minimal i jetesës,* pasi vendimi i gjykatës së apelit është ekzekutuar në mënyrë vullnetare nga Ministria e Drejtësisë dhe Gjykata e Lartë, duke vendosur për rrëzimin e padisë, ka sjellë një barrë ekonomike të rëndë e joproporcionale dhe cenim të standardit minimal të jetesës të kërkuesit në shkelje të neneve 11 dhe 41 të Kushtetutës, njëkohësisht në kundërvënie ndaj objektivave socialë dhe kushtetues, sipas nenit 59 të Kushtetutës e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

10. *Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë*, ka parashtruar si vijon:

10.1 Pretendimet e parashtruara për cenimin e *së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës, së drejtës për t'u njoftuar, për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur, parimit të kontradiktoritetit, parimit të barazisë përpara ligjit dhe parimit të sigurisë juridike* janë të pabazuara. Kërkuesi nuk ka ushtruar të drejtën për të paraqitur kundërrekurs për të parashtruar kundërshtimet e tij, megjithëse ka marrë dijeni për rekurset e paraqitura nga Avokatura e Shtetit dhe nga DAP-i.

10.2 *Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* nuk është i bazuar, pasi Gjykata e Lartë ka vepruar brenda kompetencave dhe ka arritur në përfundimin për rrëzimin e padisë, duke u bazuar mbi të njëjtat prova.

10.3 Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit* është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë, duke vlerësuar se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar gabim ligjin, ka vendosur rrëzimin e padisë duke respektuar kriteret kushtetuese në drejtim të arsyetimit të vendimit. Në fakt, pretendimi i kërkuesit lidhet me një parregullsi procedurale të kryer gjatë procesit administrativ, se vendimi për daljen në listëpritje është nënshkruar nga ministri dhe jo nga sekretari i përgjithshëm. Kjo parregullsi nuk e prek thelbin e procesit dhe lidhet me vlerësimin e fakteve e të rrethanave, i cili nuk hyn në juridiksionin kushtetues.

10.4 Pretendimi për cenimin e *standardit minimal të jetesës* është i pabazuar, pasi kërkuesit i është alokuar një shumë monetare që nuk i takon. Përveçse ai nuk ka përmendur asnjë rrethanë konkrete, nuk ka vlerësuar as vlerën e dëmit që mund t'i vijë me kthimin e detyrimit të begatuar në mënyrë të paligjshme me të ardhurat ose me burimet e tjera financiare, që mund të cenojnë standardin minimal të jetesës.

11. *Subjekti i interesuar, DAP-i,* ka parashtruar si vijon:

11.1 Pretendimi për cenimin e *së drejtës së aksesit* është i pabazuar, pasi kërkuesi nuk ka parashtruar asnjë argument në nivel kushtetues, por e ka lidhur ngushtësisht me të drejtën për t'u njoftuar, e cila është respektuar.

11.2 Pretendimi për cenimin e *së drejtës për t'u njoftuar* nuk është i bazuar, pasi, sikurse ka arsyetuar edhe Gjykata e Lartë, kërkuesi ka marrë dijeni për rekursin dhe nuk ka paraqitur kundërrekurs. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka respektuar edhe procedurën për njoftimin e datës së seancës gjyqësore, sipas parashikimeve ligjore. Për sa kohë, nuk ka cenim të së drejtës për t'u njoftuar nuk mund të pretendohet cenimi i së drejtës për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe parimi i kontradiktoritetit.

11.3 Pretendimi për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë nuk ka nxjerrë konkluzione për provat në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave më të ulëta dhe nuk ka vënë në dyshim nëse është vërtetuar ose jo fakti që lidhet me përfundimin e marrëdhënies së punës, por qëndrimi i saj lidhet me mënyrën sesi ato kanë zbatuar ligjin. Klasifikimi ligjor i veprimeve të organit publik nuk është më një çështje fakti që kërkon hetim gjyqësor të thelluar.

11.4 Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* nuk është i bazuar. Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim, ka analizuar e

vlerësuar pretendimet dhe në vendimin e saj ka respektuar standardet kushtetuese për arsyetimin e vendimit gjyqësor. Gjithashtu, fakti që Avokatura e Shtetit dhe DAP-i nuk kanë referuar në rekurs rrethanën se vendimi gjyqësor i formës së prerë është ekzekutuar lidhet me fazën e ekzekutimit të vendimit dhe jo me thelbin e mosmarrëveshjes.

11.5 Për pretendimin për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit* kërkuesi nuk ka argumentuar nëse në rastin e tij ka pasur diskriminim ose favorizim të palëve ndërgjyqëse. Mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe zbatimi i ligjit është e drejtë e çdo gjykate, sepse çdo çështje ka individualitetin e saj në harmoni me rrethanat e provat. Edhe pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* është i pabazuar, pasi nuk është ngritur në nivelin e një pretendimi me natyrë kushtetuese, sepse ka të bëjë me mënyrën e zbatimit të ligjit, që është në kompetencë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Vendimi i referuar nga kërkuesi nuk përbën vendim unifikues që mund t'i sillte pritshmëri atij në zgjidhjen e çështjes.

11.6 Pretendimi për cenimin e *standardit minimal të jetesës* nuk është i bazuar, pasi ky koncept lidhet me të ardhurat e ligjshme, të qëndrueshme e përfundimtare dhe jo me përfitime të përkohshme të realizuara në bazë të një vendimi gjyqësor. Standardi minimal i jetesës nuk mund të mbështetet në mbajtjen e një pasurie që ligji e konsideron të kthyeshme, përndryshe pasurimi do të legjitimohej pa shkak. Mundësia e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë nuk përbën cenim të standardit të jetesës.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Në referim të këtyre standardeve, Gjykata vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae* në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet objekt kundërshtimi në Gjykatë, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

14. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm. Për rrjedhojë, duke qenë se objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi i Gjykatës së Lartë, Gjykata vlerëson se në aspektin formal ai konsiderohet se i ka shteruar mjetet juridike efektive dhe se nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

15. Në aspektin substancial, subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, ka parashtruar se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive për pretendimet për cenimin e *së drejtës për t'u njoftuar, për t'u dëgjuar e mbrojtur, së drejtës së aksesit, parimit të kontradiktoritetit, barazisë përpara ligjit e të mosdiskriminimit dhe parimit të sigurisë juridike*, për sa kohë ai, megjithëse ka marrë dijeni për rekurset e paraqitura nga Avokatura e Shtetit dhe nga DAP-i, nuk ka ushtruar të drejtën për të paraqitur kundërrekurs në mënyrë që të parashtronte kundërshtimet e tij. Duke qenë se kërkuesi për këto pretendime ka parashtruar të njëjtat argumente, konkretisht se Gjykata e Lartë nuk i ka njoftuar rekurset e ushtruara nga DAP-i dhe nga Avokatura e Shtetit, arsye, sipas tij, për të cilën nuk mund të paraqiste kundërrekurs, Gjykata vlerëson se edhe aspekti substancial i kriterit të shterimit të mjeteve juridike konsiderohet i përmbushur.

16. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga

konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin konkret, vendimi më i fundit gjyqësor i dhënë në çështjen e kërkuesit, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 6.3.2025, por sipas *email*-it të depozituar së bashku me ankimin kushtetues individual i është dërguar avokatit A. D., në datën 8.4.2025. Për rrjedhojë, ankimi kushtetues individual i paraqitur në Gjykatë në datën 23.7.2025, konsiderohet brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e: i. *së drejtës për t'u njoftuar, për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur;* ii. *së drejtës së aksesit*; iii. *parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit;* iv. *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*; v. *parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit*; vi. *parimit të sigurisë juridike*; vii. *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me aksesin substancial*; viii. *standardit minimal të jetesës*.

18. Për pretendimet për cenimin e *së drejtës për t'u njoftuar, për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur, së drejtës së aksesit, parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit,* sikurse u theksua më sipër (*shih paragrafin nr. 15*), kërkuesi ka parashtruar të njëjtat argumente se Gjykata e Lartë nuk i ka njoftuar rekurset e ushtruara nga DAP-i dhe nga Avokatura e Shtetit. Ndaj, Gjykata vlerëson t'i analizojë në drejtim të *së drejtës për t'u njoftuar, për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur*.

19. Pretendimet për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit*, si dhe *parimit të sigurisë juridike* dhe *standardit minimal të jetesës,* Gjykata vëren se kërkuesi i ka lidhur me qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Lartë, duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se ajo gjykatë ka marrë vendim duke bërë vlerësim të ndryshëm të provave e fakteve të çështjes. Gjithashtu, sipas tij, Gjykata e Lartë në raste të ngjashme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës të nëpunësve civilë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga rasti i kërkuesit dhe për shkak të kësaj vendimmarrjeje ai do të detyrohet të kthejë shpërblimin e fituar me vendim gjyqësor të formës së prerë e të ekzekutuar vullnetarisht nga ministria. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë të gjitha argumentet e parashtruara, vlerëson se pretendimet do të analizohen së bashku në aspekt të respektimit të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

20. Për sa më lart, Gjykata do të analizojë pretendimet të grupuara në drejtim të: i. *së drejtës për t'u njoftuar, për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur*; ii. *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, të cilat hyjnë në juridiksionin e Gjykatës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar, për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur

21. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke mos njoftuar rekurset e paraqitura nga Avokatura e Shtetit dhe nga DAP-i, e ka vendosur atë në pamundësi për të paraqitur prapësimet e tij. Sipas tij, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhej të merrte masat e nevojshme për t'i garantuar kërkuesit të drejtën për të marrë pjesë në gjykim, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, pavarësisht faktit që gjykimi bëhet si rregull në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve.

22. Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, ka prapësuar se pretendimi është i pabazuar, pasi kërkuesi ka marrë dijeni për rekurset e paraqitura nga Avokatura e Shtetit dhe DAP-i dhe nuk ka ushtruar të drejtën për të paraqitur kundërrekurs. Edhe subjekti tjetër i interesuar, DAP-i, ndonëse nuk ka prapësuar në lidhje me njoftimin e rekursit, ka parashtruar se Gjykata e Lartë ka respektuar procedurën për njoftimin e datës së seancës gjyqësore, sipas parashikimeve ligjore. Për sa kohë nuk ka cenim të së drejtës për t'u njoftuar, nuk mund të pretendohet cenim i së drejtës për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur.

23. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për t'u njoftuar dhe për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi mosnjoftimi e vendos palën në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës *(shih vendimet nr. 40, datë 14.9.2023; nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 49, datë 22.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese)*. Për sa i takon procesit në Gjykatën e Lartë, ajo ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimin nr. 14, datë 21.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*) dhe është detyrë e administratës gjyqësore që të marrë masat për të kryer njoftimin e palëve ndërgjyqëse (*shih vendimin nr. 41, datë 29.5.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në kuptim të këtyre standardeve, Gjykata do të analizojë nëse kërkuesi ka marrë dijeni efektivisht për rekurset e ushtruara nga Avokatura e Shtetit dhe

nga DAP-i, në respektim të së drejtës për t'u njoftuar, për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur.

25. Sikur u parashtrua në rrethanat e çështjes *(shih paragrafin 5 të vendimit),* Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje mbi bazën e rekurseve të paraqitura nga DAP-i dhe nga Avokatura e Shtetit, që i janë komunikuar avokatit A. D., i cili ka nënshkruar edhe dëftesat e komunikimit të rekurseve. Nga përmbajtja e akteve të dosjes gjyqësore të administruar për efekt të gjykimit kushtetues, rezulton se kërkesëpadia e depozituar në gjykatën e shkallës së parë mban vulën dhe të dhënat e zyrës ligjore të këtij avokati, por është nënshkruar nga vetë kërkuesi. Gjatë gjykimit në shkallë të parë kërkuesi ka caktuar dy avokatë të tjerë me prokurë (E. J. dhe D. M.). Gjykata konstaton se në disa prej kërkesave të depozituara në gjykatën e shkallës së parë (kërkesë për shtesë të objektit të padisë, kërkesë për përjashtim gjyqtari, pretendime në seancën gjyqësore, konkluzione përfundimtare) në pjesën e sipërme të tyre figuron emërtimi "Zyra e Avokatit A. D." edhe pse janë të nënshkruara nga avokati E. J.

26. Gjithashtu, rezulton se në datën 13.2.2025, Gjykata e Lartë ka vendosur shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit për në datën 6.3.2025 dhe është urdhëruar sekretaria e gjykatës të bëjë njoftimin e palëve sipas nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012. Njoftimi është dërguar po në adresën e postës elektronike të avokatit A. D. Në datën 13.2.2025, është publikuar lista e çështjeve për shqyrtim në dhomën e këshillimit në datën 6.3.2025, ku përfshihej edhe çështja e kërkuesit, e cila është shpallur, sipas akteve të dosjes gjyqësore, edhe në ambientet fizike të asaj gjykate. Në përfundim të shqyrtimit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë. Sipas materialeve të vëna në dispozicion nga vetë kërkuesi, por edhe nga përmbajtja e dosjes së Gjykatës së Lartë, ka rezultuar se vendimi i Gjykatës së Lartë është dërguar në datën 8.4.2025, në adresën e postës elektronike të avokatit A. D.

27. Për sa më lart, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë të gjitha njoftimet e nevojshme i ka bërë në adresën elektronike të avokatit A. D., duke përfshirë edhe njoftimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, objekt kundërshtimi. Në kushtet kur vetë kërkuesi ka pranuar se për vendimin e Gjykatës së Lartë ka marrë dijeni në datën 8.4.2025, që në fakt i është komunikuar avokatit A. D., mund të konsiderohet se kërkuesi ka marrë dijeni edhe për rekurset e ushtruara nga DAP-i dhe Avokatura e Shtetit, të cilat gjithashtu i janë komunikuar avokatit A. D. Në këtë drejtim, Gjykata mban në konsideratë edhe faktin se, megjithëse kërkuesi kishte caktuar me prokurë avokatë të tjerë, fakti se kërkesat e tyre në procesin gjyqësor mbajnë emërtimin "Zyra e Avokatit A. D.", krijon bindjen se ai ka qenë në dijeni të ecurisë së procesit gjyqësor të tij. Ndaj, Gjykata vlerëson se mënyra sesi ka vepruar Gjykata e Lartë në rastin konkret nuk krijon dyshime për cenimin e së drejtës *për t'u njoftuar, për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur,* për rrjedhojë pretendimi i kërkuesit në këtë drejtim është i pabazuar.

B.2 Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

28. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur për themelin e çështjes duke bërë një vlerësim të ndryshëm të provave dhe të fakteve të administruara gjatë gjykimit në gjykatat më të ulëta. Sipas tij, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në raste të ngjashme, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës të nëpunësve civilë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga rasti i kërkuesit, sikurse ka qenë rasti i shtetasit A. B., që ka qenë në kushte tërësisht të njëjta me të. Për shkak të kësaj vendimmarrjeje ai do të detyrohet të kthejë shpërblimin e fituar me vendim gjyqësor të formës së prerë e të ekzekutuar vullnetarisht nga ministria.

29. Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, ka prapësuar se Gjykata e Lartë e ka arsyetuar vendimin e saj dhe se pretendimi i kërkuesit lidhet me zbatimin e ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Ndërsa subjekti tjetër i interesuar, DAP-i, ka prapësuar se Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim, ka analizuar e ka vlerësuar pretendimet dhe vendimi i saj ka respektuar standardet kushtetuese për arsyetimin e vendimit gjyqësor. Mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe zbatimi i ligjit është e drejtë e çdo gjykate, duke u bazuar në specifikat dhe individualitetin e saj të harmonizuar me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore që nuk janë të njëjta dhe se vendimi i referuar nga kërkuesi nuk përbën vendim unifikues që mund t'i sillte pritshmëri atij në zgjidhjen e çështjes.

30. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është

t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë *(shih vendimet nr. 9, datë 27.2.2024; nr. 12, datë 15.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese)*. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe në funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 12, datë 28.2.2024; nr.12, datë 19.3.2015; nr. 33, datë 8.12.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme kushtetuese, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e saj është të shqyrtojë dhe të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë *(shih vendimet nr. 63, datë 23.10.2025; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këto raste, për të mos vënë në dyshim të drejtën e gjykatave të zakonshme për të interpretuar ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, Gjykata kufizohet vetëm në identifikimin e gabimeve të dukshme, të cilat shkojnë përtej pretendimeve për interpretim të gabuar të ligjit dhe që cenojnë gjykimin e drejtë *(shih vendimin nr. 11, datë 11.2.2026, të Gjykatës Kushtetuese)*.

32. Nën dritën e standardeve të mësipërme dhe bazuar në thelbin e pretendimeve të kërkuesit, Gjykata do të analizojë nëse në rastin në shqyrtim Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka respektuar standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e vendimit gjyqësor, si dhe nëse përmban elemente arbitrariteti, në kuptim të gabimeve të dukshme, nga pikëpamja ligjore.

33. Sikurse u parashtrua në rrethanat e çështjes, ka rezultuar se kërkuesi, në datën 23.10.2014, i është drejtuar gjykatës administrative të shkallës së parë duke kundërshtuar urdhrin e ministrit të Drejtësisë për kalimin në listëpritje dhe zgjidhjen e pasojave për shkak të pavlefshmërisë së këtij urdhri. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vlerësuar se ligji i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes është ligji nr. 8549/1999. Ajo ka arsyetuar se në rastin konkret nuk jemi para suprimimit të vendit të punës dhe se nuk plotësohen kushtet dhe rrethanat për të lejuar kalimin në listëpritje. Sipas gjykatës së shkallës së parë, vendimi nr. 413/4/1, datë 1.11.2013, "Për daljen në listëpritje", i marrë nga ministri i Drejtësisë, pavarësisht rrethanave që e kanë imponuar, është një vendim i marrë jashtë kompetencave të tij pasi kjo kompetencë i është dhënë sekretarit të përgjithshëm. Si konkluzion, ky vendim i marrë nga një organ jokompetent dhe në kuptim të nenit 116 të Kodit të Procedurave Administrative, është një akt absolutisht i pavlefshëm. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka arsyetuar se justifikimi i përdorur nga Avokatura e Shtetit se vendimi i marrë nga ministri për shkak të vakancës së pozicionit të sekretarit të përgjithshëm është i pabazuar *(shih faqen 10, të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë)*. Sipas kësaj gjykate, dakordësia e shprehur prej tij për të kaluar në listëpritje deri në gjetjen e mundësive të sistemimit sipas strukturës së re nuk do të thotë se ai është dorëhequr, edhe sepse dhënia e pëlqimit nuk parashikohet si element i domosdoshëm për kalimin e nëpunësit civil në listëpritje *(shih faqen 11, të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë)*.

34. Në ndryshim nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se për zgjidhjen e rastit konkret është i zbatueshëm ligji nr. 152/2013. Ajo ka arsyetuar se urdhri i largimit është disponuar nga ministri i Drejtësisë, i cili nuk

identifikohet me organin kompetent të parashikuar nga ligji për disponimin e akteve që konfirmojnë lirimin nga detyra të nëpunësit civil dhe kalimin e tij në listëpritje *(shih faqen 21, të vendimit të gjykatës së apelit)*. Vetëm fakti i mosrespektimit nga pala e paditur të kësaj rrethane, pa i hyrë analizës së ekzistencës ose jo të rrethanave që diktuan vendimmarrjen objekt gjykimi, për atë gjykatë ka qenë i mjaftueshëm për të vlerësuar moscenimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

35. Ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë fillimisht ka konstatuar se ligji nr. 8549/1999 është i zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes dhe se kërkuesi ka nënshkruar deklaratë ku shprehej për dakordësinë për kalimin në listëpritje, për shkak të suprimimit të pozicionit të tij të punës. Në vijim, DAP-i ka miratuar kalimin e kërkuesit në listëpritje dhe ministri i Drejtësisë, me vendimin nr. 413/4/1, datë 1.11.2013, "Për daljen në listëpritje" ka vendosur kalimin e kërkuesit në listëpritje. Në këtë pikë arsyetimi, Kolegji ka vlerësuar se argumenti i gjykatave më të ulëta se ministri i Drejtësisë rezulton të ketë disponuar në shmangie të kompetencave të parashikuara nga ligji, pasi nuk është organi kompetent për marrjen e vendimit të kalimit të nëpunësit civil në listëpritje, është i gabuar për sa i përket efektit të vlerësuar prej gjykatave në lidhje me pavlefshmërinë absolute të aktit. Sipas Gjykatës së Lartë, duke qenë se pozicioni i sekretarit të përgjithshëm ishte vakant, ndonëse ligji parashikon se vendimi për kalimin në listëpritje është kompetencë e tij, në mungesë të këtij të fundit, kur akti nënshkruhet nga ministri, nuk jemi në kushtet e pavlefshmërisë absolute të aktit, përderisa është provuar që ekziston shkaku i kalimit në listëpritje dhe për më tepër është shprehur në atë kohë edhe dakordësia nga kërkuesi për kalimin në listë pritje. Ndërhyrja e tij në këtë situatë, pra nënshkrimi i aktit objekt gjykimi, ishte pikërisht fakti se pozicioni i sekretarit të përgjithshëm ishte vakant. Kjo parregullsi procedurale nuk prek thelbin e vendimmarrjes, e cila nuk është kundërshtuar as nga kërkuesi në atë kohë dhe as DAP-i nuk e ka gjetur të parregullt propozimin për kalimin në listëpritje. Në këto kushte, në kontekstin e rrethanave të faktit, nuk mund të pretendohet për shkelje "flagrante" të tillë që mund të sjellë pavlefshmëri absolute të aktit. Shkelja në këtë rast, edhe nëse ka ekzistuar, është vetëm e natyrës formale dhe nuk prek thelbin e vendimmarrjes *(shih paragrafin 16, të vendimit të Gjykatës së Lartë)*.

36. Në analizë të sa më sipër, Gjykata vëren se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ndonëse ka pranuar se ligji i zbatueshëm në rastin e kërkuesit, konkretisht ligji nr. 8549/1999, ia njeh kompetencën për nxjerrjen e vendimit të kalimit në listëpritje sekretarit të përgjithshëm, ka arritur në përfundimin se nënshkrimi i aktit nga ministri i Drejtësisë nuk përbën shkak për pavlefshmëri absolute. Ky kolegj është bazuar në argumentin se, për sa kohë që pozicioni i sekretarit të përgjithshëm ka qenë vakant, ka ekzistuar shkaku ligjor për kalimin në listëpritje, si dhe kërkuesi ka shprehur dakordësinë e tij për këtë masë. Ndërkohë, nga përmbajtja e dispozitave të ligjit nr. 8549/1999, si dhe të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", nuk rezulton se ministrit, si funksionar politik, i është njohur kompetenca për të ushtruar atributet që ligji ia rezervon sekretarit të përgjithshëm në marrëdhëniet e shërbimit civil. Me fjalë të tjera, ministri, si funksionar me natyrë politike dhe pjesë e pushtetit ekzekutiv në nivel politikëbërës, nuk mund të ushtrojë kompetenca administrative për emërimin, vlerësimin ose largimin e nëpunësve civilë, të cilat ligji ia atribuon organeve të administratës civile të përcaktuara shprehimisht. Ky aspekt është trajtuar edhe nga gjykatat e faktit të cilat kanë arritur në përfundimin se vendimi i ministrit të Drejtësisë ishte nxjerrë jashtë kompetencave të tij ligjore, pavarësisht rrethanave që mund të kenë diktuar ndërhyrjen e tij. Në këto kushte, argumenti i Gjykatës së Lartë se ndërhyrja e ministrit justifikohej nga mungesa e sekretarit të përgjithshëm nuk shoqërohet me një analizë të dispozitave ligjore që do të mund të mbështesnin qëndrimin e saj. Një qëndrim i tillë jo vetëm është formalist, por edhe arbitrar, në kuptim të gabimeve të dukshme nga pikëpamja ligjore.

37. Nga ana tjetër, Gjykata çmon se fakti i evidentuar nga Gjykata e Lartë se kërkuesi kishte shprehur dakordësinë e tij për kalimin në listëpritje nuk përbën një rrethanë përcaktuese për vlerësimin e kompetencës së organit që ka nxjerrë aktin administrativ. Pëlqimi i subjektit të prekur nga akti nuk mund të zëvendësojë ose të plotësojë mungesën e kompetencës së organit që e nxjerr atë. Për rrjedhojë, në rastin konkret, dakordësia e kërkuesit nuk legjitimon ushtrimin e një kompetence që ligji ia ka atribuar një organi tjetër. Po kështu, edhe

arsyetimi i Gjykatës së Lartë, sipas të cilit pasojat do të kishin qenë të njëjta edhe nëse vendimi do të ishte marrë nga sekretari i përgjithshëm, për sa kohë që kërkuesi kishte shprehur vullnetin e tij, mbështetet në një vlerësim hipotetik të rezultatit të procedurës dhe jo në verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore që përcaktojnë vlefshmërinë e aktit administrativ. Një qasje e tillë nuk merr në konsideratë faktin se nenet 21 dhe 23, të ligjit nr. 8549/1999, rregullojnë në mënyrë të posaçme procedurat dhe organet kompetente për lirimin nga shërbimi civil dhe kalimin në listëpritje në rastet e ristrukturimit të administratës, duke vendosur garanci procedurale që nuk mund të anashkalohen.

38. Për më tepër, Gjykata evidenton se kërkuesi në mbështetje të pretendimeve të tij ka paraqitur vendimin nr. 00-2025-31 (4), datë 14.1.2025, të Gjykatës së Lartë, në të cilin është arsyetuar se veprimi administrativ i kalimit në listëpritje, i kryer nga ministri i Drejtësisë, nuk rezulton të jetë kryer nga personi zyrtar përgjegjës brenda kompetencave të përcaktuara nga ligji nr. 8549/1999. Megjithëse ky vendim nuk është njësues për praktikën gjyqësore, Gjykata vëren se, në rastin konkret, Gjykata e Lartë, ndonëse konkurrojnë të njëjtat rrethana me atë të shqyrtuar në rastin e vendimit të lartpërmendur, ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm për pasojat juridike që sjell ushtrimi i kompetencës nga një organ i papërcaktuar nga ligji, pa dhënë arsye të mjaftueshme për të justifikuar këtë ndryshim qasjeje. Në këto kushte, arsyetimi i saj konsiderohet i pamjaftueshëm për të shpjeguar se përse në njërin rast mungesa e kompetencës konsiderohet element me rëndësi për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit, ndërsa në rastin tjetër vlerësohet si një parregullsi thjesht formale. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është i bazuar.

39. Po kështu, Gjykata vëren se kërkuesi ka kërkuar edhe pezullimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, me argumentin se nëse nuk merret një masë e tillë me efekt të përkohshëm, ankimi kushtetues individual nuk do të kishte asnjë efekt dhe do të ngelej iluziv. Ekzekutimi i vendimit do të sillte një barrë të rëndë për kërkuesin në anën ekonomike dhe në standardin minimal të jetesës. Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, ka prapësuar se kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë rrethanë konkrete sesi mund të cenohet nga ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Lartë. Pavarësisht se vendimi i gjykatës së apelit është ekzekutuar plotësisht pas vendimit të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur rrëzimin e padisë, kërkuesi detyrohet të kthejë përfitimet e marra nga vendimi gjyqësor i ekzekutuar.

40. Në lidhje me kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata vlerëson se ardhja e pasojave të pretenduara nga kërkuesi nuk është e pariparueshme ose që të justifikojë pezullimin e aktit. Për këtë arsye, kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Lartë nuk është e bazuar.

41. Në përfundim, sipas arsyetimit të mësipërm, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuesit është e bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-826 (100), datë 6.3.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 30.4.2026.
Shpallur më 25.6.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji
Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Marjana Semini

VENDIM
Nr. 55, datë 6.5.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Asim Vokshi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 30.4.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (Dh) 2025 të Regjistrit Themeltar që u përket:

KËRKUES: Dhimë Qurku
Anastasia Qurku

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, përfaqësuar nga drejtoresha e departamentit ligjor Fatjola Halilaj.

Avokatura e Shtetit, përfaqësuar nga avokatët e shtetit Valbona Legisi, Irma Qosja dhe Denisa Skënderaj.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 20-2019-984/413, datë 16.12.2019, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër; nr. 00-2025-709, datë 19.2.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, 41, 42, 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)* dhe neni 1, i Protokollit nr. 12 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesve Dhimë Qurku dhe Anastasia Qurku *(kërkuesit)*, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike *(OSHEE)* dhe Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë trashëgimtarët (prindërit) e shtetasit Edmond Qurku, i cili në datën 18.2.2016, ka qenë duke punuar për montimin e një tende në një apartament që ndodhet në rrugën kryesore "Butrint–Kanali i Çukës". Gjatë manovrimit të tendës, për shkak të kontaktit të një tubi me gjatësi 6 metër, që e mbante nën sqetull, me linjën ajrore të ndërtuar në shtyllat e tensionit 10 kV, të ndodhur përballë banesës, shtetasit Edmond Qurku i është shkaktuar vdekja e menjëhershme. Organi i prokurorisë në bazë të të dhënave ka arritur në përfundimin se fakti i ndodhur nuk parashikohej si vepër penale dhe, në këto kushte, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

2. Kërkuesit jetonin në një ekonomi familjare me djalin e tyre dhe, nisur nga rrethanat e ngjarjes së rëndë, kanë pretenduar se shkaku i humbjes së jetës ka qenë mosrespektimi i rregullave dhe mosmarrja e masave të nevojshme nga OSHEE-ja për të parandaluar dëmet që shkaktohen nga kontakti i padëshiruar me përcjellësit elektrikë ajrorë. Për këtë arsye, ata i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e OSHEE-së të paguajë dëmshpërblimin për dëmin pasuror dhe jopasuror, në formën e dëmit biologjik, moral dhe ekzistencial në shumën 23.702.270 lekë.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 23-2018-704(339), datë 23.4.2018, ka vendosur: i. pranimin e kërkesëpadisë; ii. detyrimin e OSHEE-së të dëmshpërblejë kërkuesit për dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar si rezultat i ngjarjes së datës 18.2.2016, me pasojë vdekjen e shtetasit Edmond Qurku, në shumën totale 23.702.270 (njëzet e tre milionë, shtatëqind e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka arsyetuar se OSHEE-ja i ka vendosur përcjellësit elektrikë në rrugën "Turizëm–Kanali i Çukës" në shkelje të rëndë të distancave të lejuara në objektin e banimit. Gjatë gjykimit të çështjes, për shkak të karakterit teknik të

problematikës, është thirrur edhe një ekspert inxhinier elektrik. Sipas mendimit të ekspertit, lartësia e shtyllave që mbanin përcjellësin elektrik dhe distanca nga përcjellësi tek godina ishin në shkelje të largësisë së lejuar sipas pikave 11.2. dhe 5.5. të rregullores së Kushteve Teknike të Projektimit dhe rregullores së Sigurimit Teknik, që parashikon se në vendet e banuara linjat elektrike ajrore (në gjendje të qetë) duhet të jenë 10 metra distancë nga objektet e banimit, por, në rastin konkret, largësia horizontale ishte 1.98–2 metra. Nëse largësia do të ishte sipas normës së lejuar, ai nuk do të kishte mundësi kontakti me rrymën elektrike. OSHEE-ja kishte për detyrë të kontrollonte të gjithë linjën elektrike për siguri, si dhe të vendoste në zonë e në shtyllë tabela sinjalizuese të rrezikut. Gjithashtu, sipas gjykatës së shkallës së parë, OSHEE-ja (bazuar në aktin e ekspertimit elektrik) është përgjegjëse që nuk ka vendosur linjat e tensionit 10 kV në distancat e lejuara të parashikuara nga rregullorja e Kushteve Teknike të Projektimit e vitit 1978 dhe nga rregullorja e Sigurimit dhe e Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Pajisjet dhe Instalacionet Elektrike, e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 148, datë 9.12.1967, në raport me objektet e banimit, posaçërisht me pallatin ku ka ndodhur ngjarja e rëndë. Nëse linja elektrike do të ishte vendosur në largësinë e lejuar, bazuar në rrethanat e ngjarjes, nuk do të ekzistonte asnjë mundësi potenciale që tubi që mbante nën sqetull i ndjeri Edmond Qurku të prekte përcjellësin ajror elektrik. Në këto rrethana është provuar se pala e paditur/OSHEE-ja ka pasur faj *(shih faqet 5–15, të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë).* Gjatë gjykimit, për të provuar dëmin moral dhe dëmin ekzistencial, është thirrur edhe eksperti psikologjik që ka vlerësuar se familjarëve u është shkaktuar një dëmtim i konsiderueshëm nga pikëpamja sociale, familjare dhe psikologjike.

4. Ndaj vendimit ka paraqitur ankim OSHEE-ja. Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 20-2019-984/413, datë 16.12.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 23-2018-704 (339), datë 23.4.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë. Gjykata e Apelit Gjirokastër ka arsyetuar se është e vërtetë që OSHEE-ja nuk ka respektuar distancën 6.5 metra sipas ekspertit të shkallës së parë dhe 2.5 metra sipas ekspertit B. R. (të caktuar nga gjykata e apelit), por edhe nëse do të zbatoheshin largësitë e përcaktuara nga ekspertët dhe do të kishte pasur erë, përsëri do të kishte ndodhur aksidenti, për shkak të pakujdesisë së viktimës *(shih faqen 16, të vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër).*

5. Në datën 20.2.2020, kërkuesit kanë ushtruar rekurs, ndërsa, në datën 17.2.2025, kanë paraqitur parashtrime/shpjegime rreth shkaqeve të paraqitura në rekurs. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-709, datë 19.2.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit. Sipas Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë: i. Gjykata e Apelit Gjirokastër ka respektuar normat procedurale, të cilat mund të çojnë në pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor ose të procedurës së gjykimit. Nuk rezulton të ketë shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit; ii. palëve iu është dhënë mundësia të realizojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë për to, të shprehin qëndrimin e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes; iii. Gjykata e Apelit Gjirokastër ka respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e ligjit material. Kjo gjykatë ka bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe të rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen, ka kryer një analizë juridike të plotë të provave dhe e ka zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi; iv. vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit Gjirokastër nuk bie në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

6. Në datën 17.6.2025, kërkuesit, nëpërmjet shërbimit postar, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar më 4.7.2025. Kolegji i Gjykatës, gjatë shqyrtimit paraprak, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. *Kërkuesit*, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se gjatë procesit gjyqësor është cenuar:

7.1 *E drejta për proces të rregullt ligjor,* e garantuar në nenin 42 të Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

7.1.1 *E drejta e aksesit,* pasi gjatë gjykimit në gjykatën e apelit janë paraqitur pretendime se linja elektrike në vendin e ngjarjes ishte në shkelje të nenit 11.2. të rregullores së Kushteve Teknike dhe Projektimit, si dhe për mungesën e një tabele lajmëruese sipas nenit 5.34, të rregullores së Sigurimit Teknik, por ajo gjykatë ka heshtur për të gjitha kërkimet dhe nuk ka dhënë përgjigje nëse vendosja e linjës elektrike ishte në përputhje me rregulloret dhe me ligjin e urbanistikës. Të gjitha pretendimet e parashtruara ishin në funksion të mbrojtjes të së *drejtës kushtetuese të jetës, së drejtës për familje dhe së drejtës për një mjedis të sigurt,* pasi jeta e të afërmit të tyre është privuar sepse punonte në një mjedis të pasigurt, për shkak të shkeljeve. Të gjitha këto pretendime nuk janë analizuar nga gjykata e apelit. Ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij nuk ka cituar as formalisht pretendimet, duke shkelur të drejtën për të pasur një vendim të arsyetuar.

7.1.2 *E drejta për gjykim të drejtë,* pasi gjykata e apelit, megjithëse ka urdhëruar kryesisht përsëritjen e hetimit gjyqësor, nuk ka arsyetuar se përse pretendimi i ngritur nga kërkuesit për vendosjen pa leje të linjës elektrike nuk përbën një veprim të paligjshëm me pasojë vdekjen nga kontakti elektrik. Gjykata e apelit nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve se linja elektrike 10 kV ka shkelur nenin 11.2, të rregullores së Kushteve Teknike të Projektimit, që detyron OSHEE-në ta vendosë linjën 10 metra larg objekteve të banimit dhe se nuk ka pasur asnjë tabelë paralajmëruese për rrezikun nga afërsia e telave elektrikë me pallatin. Pretendimet për zbatimin e gabuar të ligjit material u parashtruan edhe në rekurs, por Gjykata e Lartë, megjithëse i ka rreshtuar si shkaqe, nuk u ka dhënë përgjigje asnjë prej pretendimeve, duke krijuar dyshime të arsyeshme se ka neglizhuar trajtimin e tyre.

7.1.3 *E drejta për ankim substancial dhe standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi në vendimin e gjykatës së apelit nuk gjendet asnjë arsyetim, qoftë edhe refuzues, se përse pretendimet e ngritura për vendosjen e linjës elektrike pa leje nga organet e pushtetit lokal për moszbatimin e masës së sigurimit teknik dhe moszbatimin e rregullores së Sigurimit Teknik nuk përbëjnë veprime të paligjshme që kanë sjellë, si pasojë, vdekjen. Mungesa e një arsyetimi refuzues është e barabartë me situatën sikur kërkuesit nuk kanë qenë asnjëherë të pranishëm në procesin gjyqësor. Gjykata e Lartë, duke u bazuar edhe në natyrën e pretendimeve, duhet të jepte përgjigje të arsyetuar.

7.2 *E drejta e jetës,* e garantuar në nenin 21 të Kushtetutës, pasi Gjykata e Apelit Gjirokastër ka lejuar shkeljen e kësaj të drejte duke shpërfillur detyrimin ligjor që kishte OSHEE-ja, e cila, përpara se të montonte një rrjet elektrik 10 kV në një zonë të banuar, duhej të pajisej me leje ndërtimi. Megjithëse gjykata e apelit është vënë në dijeni zyrtarisht nga Bashkia e Sarandës se linja elektrike në atë zonë banimi është vendosur nga OSHEE-ja pa pasur leje ndërtimi, ajo nuk e ka çmuar këtë fakt të paligjshëm, me pasojë fatale për viktimën. Duke vepruar në këtë mënyrë, gjykata e apelit nuk ka respektuar dhe nuk ka mbrojtur të drejtën e jetës. Edhe Gjykata e Lartë ka lejuar *cenimin e së drejtës së jetës,* duke arsyetuar se subjekti që shfrytëzon atë linjë elektrike nuk ka asnjë përgjegjësi ligjore për vdekjen.

7.3 *E drejta për familje,* e garantuar në nenin 53 të Kushtetutës, pasi çdo qytetar gëzon të drejtën për të pasur familje. Gjykata e apelit nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit se ngjarja fatale ka cenuar edhe të drejtën për të pasur jetë të qetë familjare, duke shkatërruar marrëdhënien prind-bir. Gjykata e apelit nuk ka arsyetuar se përse është lejuar OSHEE-ja të shfrytëzojë atë rrjet elektrik në kundërshtim me çdo normë ligjore. Askush nuk mund të jetë i sigurt në të ardhmen, pasi familja e tij mund të cenohet nëse një familjar bie në kontakt me atë rrjet elektrik. Në të njëjtën linjë qëndron edhe vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka lënë pa vëmendje dhe pa kontroll *respektimin e së drejtës familjare* të cenuar si pasojë e vdekjes së djalit të kërkuesve.

7.4 *E drejta për mjedis të sigurt,* e garantuar në nenin 56 të Kushtetutës. Gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë, bazuar edhe në mendimin e ekspertëve, u vlerësua se linja elektrike ku ka ndodhur aksidenti ishte vendosur në shkelje të dy rregulloreve që standardizojnë largësinë horizontale të përcjellësve elektrikë ajrorë nga banesat dhe se linja ajrore ishte e vendosur pa leje ndërtimi. Gjatë gjykimit në gjykatën e apelit është kryer një tjetër akt ekspertimi elektrik, sipas të cilit linja elektrike nuk ishte e sigurt. Gjykata e apelit ka cenuar *të drejtën për të pasur mjedis të sigurt* nga kontakti elektrik me linjën 10 kV kur nëpërmjet arsyetimit të vendimit nuk ka pranuar mendimin e dy ekspertëve, sipas të cilëve lidhja shkak-pasojë nuk do të ndodhte nëse linja elektrike do të ishte vendosur 10 metra larg pallatit,

në respektim të largësisë horizontale të përcjellësit ajror elektrik me banesat (sipas nenit 11.2, të rregullores së Kushteve të Projektimit ose 6.5 metra larg pallatit sipas nenit 5.5, të rregullores së Sigurimit Teknik). Gjithashtu, i njëjti qëndrim vërehet në vendimin standard të Gjykatës së Lartë.

8. *Subjekti i interesuar, OSHEE-ja,* ka prapësuar si vijon:

8.1 *Pretendimet për të drejtën për proces të rregullt ligjor* në drejtim të*:*

8.1.1 *Së drejtës së aksesit në gjykatë, për një gjykim të drejtë, të së drejtës së ankimit dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk janë të bazuara,* pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë zhvilluar një hetim të plotë dhe kanë respektuar parimin e kontradiktoritetit. Gjykata e Lartë, me të drejtë, ka vendosur mospranimin e rekursit në kushtet kur shkaqet e parashtruara lidheshin me vlerësimin e provave.

8.2 *Pretendimi për cenimin e së drejtës së jetës jo vetëm parashtrohet për herë të parë në ankimin kushtetues individual,* por kërkuesit nuk legjitimohen, pasi kjo e drejtë bën pjesë në kategorinë e lirive dhe të drejtave vetjake. E drejta e jetës, referuar nenit 21 të Kushtetutës, lidhet drejtpërdrejt me individin që e gëzon dhe nuk mund të kërkohet përveçse nga ai që e gëzon.

8.3 *Pretendimi për cenimin e së drejtës për një mjedis të sigurt gjithashtu* parashtrohet për herë të parë në Gjykatë. Pavarësisht kësaj, pretendimi është i pabazuar, sepse kërkuesit nuk kanë paraqitur asnjë argument kushtetues dhe argumentet e tyre kanë të bëjnë me vlerësimin e provave e me interpretimin e ligjit. Nga të gjitha provat është arritur në përfundimin se i ndjeri ka humbur jetën, por nuk është provuar se kjo ka ndodhur për shkak të mosrespektimit të rregullave nga OSHEE-ja. Për rrjedhojë, që të kërkohet shpërblimi i dëmit duhet të ekzistojnë të gjitha elementet në mënyrë kumulative (dëmi/lidhja shkakësore/veprimi ose mosveprimi/faji), ndaj në këtë rast mungon përgjegjësia e organit publik.

9. *Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit*, ka prapësuar si vijon:

9.1 *Pretendimet për të drejtën për proces të rregullt ligjor,* në drejtim të:

9.1.1 *Së drejtës së aksesit në gjykatë, për një gjykim të drejtë, të së drejtës së ankimit dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* janë haptazi të pabazuara*,* pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm iu kanë dhënë përgjigje të arsyetuara çdo kërkimi për shpërblimin e dëmit. Interpretimi dhe zbatimi i ligjit nuk rezulton të jenë arbitrarë dhe nuk paraqesin probleme në aspektin kushtetues. Edhe Gjykata e Lartë nëpërmjet vendimit të saj për mospranimin e rekursit u ka dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve.

9.2 *Pretendimi për cenimin e së drejtës së jetës është i pabazuar,* pasi Gjykata e Apelit Gjirokastër, gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka bërë një vlerësim të ri të provave dhe të fakteve, si dhe, bazuar në aktet e ekspertimit, ka vlerësuar për rrëzimin e kërkesëpadisë. Ndryshe nga sa pretendojnë kërkuesit, nuk rezulton të ketë shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit të kuptim të nenit 21 të Kushtetutës dhe nenit 2 të KEDNJ-së për të drejtën e jetës. Ngjarja ka ndodhur si pasojë e kontaktit të pavullnetshëm/aksidental me linjën elektrike. Sistemi ligjor e rregullator në sektorin e energjisë ka qenë funksional dhe i zbatueshëm, si dhe të gjitha organet përgjegjëse, duke përfshirë edhe prokurorinë, kanë kryer hetimet e tyre. Në këto kushte, nuk ekziston lidhja e nevojshme e shkakësore ndërmjet veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme të palës së paditur/OSHEE-së dhe pasojës së ardhur.

9.3 *Pretendimi për cenimin e së drejtës për të pasur familje dhe për një mjedis të sigurt,* kërkuesit nuk i kanë ngritur gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Gjirokastër dhe as në rekursin e ushtruar në Gjykatën e Lartë. Bazuar në parimin e subsidiaritetit, këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim, pasi nuk janë ngritur në çdo shkallë të gjykimit.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

10. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë

kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, Gjykata vëren se kërkuesit, në cilësinë e trashëgimtarëve, kanë ngritur kërkesëpadi në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për të kërkuar shpërblimin e dëmit nga humbja e jetës së djalit të tyre, proces i cili ka përfunduar me mospranimin e rekursit të tyre nga Gjykata e Lartë. Për rrjedhojë, kërkuesit justifikojnë interesin në çështjen kushtetuese të parashtruar në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës.

12. Kriteri për shterimin e mjeteve nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 40, datë 14.5.2024; nr. 38, datë 12.7.2023; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata verifikon nëse për pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual kërkuesit i kanë shteruar mjetet e zakonshme të ankimit, pra nëse i kanë ngritur ato paraprakisht përpara gjykatave të zakonshme.

13. Gjykata vëren se kërkuesit i janë drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm të vënë në lëvizje prej tyre nëpërmjet padisë, ankimit dhe rekursit, duke i shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion nga ana formale. Për sa i takon substancës së pretendimeve, kërkuesit ankohen edhe për procesin gjyqësor të zhvilluar nga Gjykata e Lartë, për të cilin i vetmi mjet juridik në dispozicion është ankimi kushtetues individual. Në lidhje me pretendimin *për një mjedis të sigurt*, të garantuar në nenin 56 të Kushtetutës, Gjykata vëren se nga përmbajtja e rekursit kërkuesit nuk e kanë parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të shprehur këtë pretendim, sikurse e kanë paraqitur në ankimin kushtetues individual dhe, për rrjedhojë, Gjykata vlerëson të mos e marrë në shqyrtim, sepse ata nuk i kanë shteruar mjetet juridike efektive, gjë që është prapësuar me të drejtë edhe nga subjektet e interesuara.

14. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 19.2.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 17.6.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae,* Gjykata konstaton se kërkuesit kanë parashtruar pretendime për cenimin e së *drejtës së jetës, për familje, të së drejtës së aksesit, të gjykimit të drejtë, si dhe të ankimit substancial dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

16. Gjykata vëren se për pretendimin për cenimin *e së drejtës për familje,* të garantuar në nenin 53 të Kushtetutës, nga përmbajtja e rekursit kërkuesit e kanë parashtruar dhe argumentuar këtë pretendim të lidhur në substancë me cenimin e së *drejtës së jetës* të familjarit të tyre, për shkak të mosmarrjes së masave të nevojshme nga organet përgjegjëse, gjë që ka sjellë edhe shuarjen e marrëdhënies prind-fëmijë dhe, për këtë arsye, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e s*ë drejtës për jetë familjare* lidhet me kërkimin kryesor të tyre për cenimin e *së drejtës së jetës*, prandaj argumentet e paraqitura do të mbahen në konsideratë gjatë analizës së tij.

17. Gjithashtu, kërkuesit kanë parashtruar pretendime për cenimin e së *drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për aksesit, gjykimit të drejtë, ankimit substancial dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi, sipas tyre, vendimi i gjykatës së apelit dhe vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili i ka dhënë fund procesit gjyqësor, nuk i kanë dhënë përgjigje kërkimit se cili institucion ishte përgjegjës për zbatimin e rregullave për sigurimin e jetës dhe të shëndetit, moszbatimi i të cilave ka sjellë humbjen e jetës së familjarit të tyre. Gjykata vëren se, në thelb, të gjitha pretendimet e mësipërme, të cilat lidhen me procesin e rregullt ligjor, janë renditur nga kërkuesit me të njëjtat argumente që analizojnë cenimin e së drejtës së jetës.

18. Lidhur me *të drejtën e jetës*, e cila ka qenë objekt i gjykimit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, evidentohet se neni 21 i Kushtetutës parashikon se jeta e personit mbrohet me ligj, duke vendosur në këtë mënyrë detyrime pozitive, në radhë të parë, për ligjvënësin që të parashikojë rregulla ligjore për mbrojtjen e jetës së individit dhe më pas për gjykatat e zakonshme, të cilat kanë përgjegjësinë e verifikimit nëse detyrimet ligjore për mbrojtjen e jetës janë

përmbushur nga institucionet shtetërore të ngarkuara nga ligji. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumentet e kërkuesve për cenimin e së drejtës e jetës dhe së drejtës për jetë familjare lidhen me procesin gjyqësor të zhvilluar, vlerëson që ato të shqyrtohen në themel në drejtim *të së drejtës së aksesit dhe arsyetimit të vendimit gjyqësor*, si aspekte të procesit të rregullt ligjor, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës. Ky i fundit gjithashtu parashikon se të drejtat e njohura me Kushtetutë (ku përfshihet edhe e drejta e jetës), nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

19. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se çështja e paraqitur do të vlerësohet në këndvështrim *të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit*, të cilat hyjnë në juridiksionin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit

20. Kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Apelit Gjirokastër nuk ka arsyetuar se përse OSHEE-ja është lejuar të shfrytëzojë rrjetin elektrik në kundërshtim me çdo normë ligjore dhe nëse ky institucion është përgjegjës për pasojën e ardhur. Gjykata e apelit ka heshtur për të gjitha kërkimet, për më tepër për kërkimin kryesor, për cenimin e së drejtës së jetës të familjarit të kërkuesve. Edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij, megjithëse i ka listuar shkaqet e rekursit, ka përsëritur shkeljet e gjykatës së apelit, pasi nuk ka arsyetuar për kërkimin thelbësor. Gjykata e Lartë, duke u bazuar edhe në natyrën e pretendimeve (natyrë kushtetuese), duhet të jepte përgjigje të arsyetuara, duke mbajtur në konsideratë se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar kërkimet si të bazuara në ligj, ndryshe nga gjykata e apelit.

21. Subjekti i interesuar, OSHEE-ja, ka prapësuar se pretendimet janë të pabazuara, pasi kërkuesit nuk kanë paraqitur asnjë argument kushtetues dhe se ato kanë të bëjnë me vlerësimin e provave. Nga të gjitha provat e paraqitura nuk është provuar se humbja e jetës ka ndodhur për shkak të mosrespektimit të rregullave nga OSHEE-ja. Gjykata e Lartë, me të drejtë, ka vendosur mospranimin e rekursit në kushtet kur shkaqet e parashtruara lidheshin me vlerësimin e provave.

22. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm u kanë dhënë përgjigje të arsyetuara çdo kërkimi për shpërblimin e dëmit dhe se interpretimi e zbatimi i ligjit nuk rezulton të jetë arbitrarë dhe nuk paraqesin probleme në aspektin kushtetues. Gjatë shqyrtimit të çështjes nuk rezultoi të kishte shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit në kuptim të nenit 21 të Kushtetutës dhe nenit 2 të KEDNJ-së në lidhje me të drejtën e jetës. Ngjarja ka ndodhur si pasojë e kontaktit të pavullnetshëm/aksidental me linjën elektrike.

23. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ajo u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 10, datë 12.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal *(shih vendimet nr. 11, datë 11.2.2026, nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese).*

24. Gjykata ka pohuar se e drejta e aksesit ka për qëllim të garantojë shtetasit që pretendimet e tyre për cenimin e të drejtave kushtetuese e ligjore, përfshirë rastet kur cenimi vjen nga një akt i administratës shtetërore, do të marrin përgjigje nga autoritetet përkatëse shtetërore. Shteti i së drejtës presupozon që çdo ndërhyrje e autoriteteve shtetërore në të drejtat e individit ose të personave juridikë duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një instancë që garanton pavarësinë dhe paanësinë gjatë procesit të shqyrtimit *(shih vendimet nr. 38, datë 19.3.2026; nr. 70, datë 24.11.2016; nr. 10, datë 4.4.2007, të Gjykatës Kushtetuese).*

25. Sipas Gjykatës, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese të procesit të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë *(shih vendimin nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese).* Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e

subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to *(shih vendimet nr. 10, datë 13.3.2025; nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese)*.

26. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 33, datë 30.5.2023; nr. 11, datë 10.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar se standardi i arsyetimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është e drejta e aksesit në gjykim dhe e drejta e ankimit efektiv (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*.

27. Gjykata ripohon se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 14, datë 14.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë *(shih vendimet nr. 3, datë 21.1.2025; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 29, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata do të verifikojë nëse kërkuesit kanë marrë përgjigje përfundimtare për kërkimin për dëmin e shkaktuar nga humbja e jetës së familjarit të tyre, duke shqyrtuar nëse është analizuar në mënyrë të mjaftueshme dhe të nevojshme nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në drejtim të parashikimeve ligjore, si dhe nëse vendimi i Gjykatës së Lartë është në përputhje me standardet kushtetuese të arsyetimit.

29. Gjykata vëren se në kohën e humbjes së jetës të familjarit të kërkuesve, rregullat për sigurinë e njerëzve nga rreziku elektrik dhe masat që duhet të merrte personi juridik për instalimet elektrike parashikoheshin në ligjin nr. 8734, datë 1.2.2001, "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike", të ndryshuar *(ligji nr. 8734/2001)*. Sipas këtyre parashikimeve ligjore, pajisjet, instalimet dhe rrjetet elektrike duhej të plotësonin kërkesat e sigurisë, të përcaktuara në rregulloret në fuqi për projektimin, përdorimin, shfrytëzimin dhe vlerësimin e konformitetit (pika 1, e nenit 3, të ligjit nr. 8734/2001). Pajisjet, instalimet dhe rrjetet elektrike përpara vënies në shfrytëzim duhej të kontrolloheshin në aspektin e sigurisë së jetës së njerëzve, të kafshëve shtëpiake ose të vlerave materiale nga specialisti elektrik i caktuar posaçërisht nga subjekti furnizues me energji elektrike (pika 1, e nenit 6, të ligjit nr. 8734/2001). Personi juridik që përdor pajisje ose instalime elektrike merr të gjitha masat për të kryer kontrollin teknik periodik të çdo pajisjeje ose instalimi, sipas afateve të përcaktuara në rregulloret e sigurimit teknik për pajisjet dhe instalimet elektrike të miratuara nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit (pika 2, e nenit 6, të ligjit nr. 8734/2001).

30. Gjithashtu, referuar legjislacionit të kohës, Gjykata konstaton se detyrimet kryesore që lidheshin me operatorët e shpërndarjes së energjisë elektrike rregulloheshin nga ligji nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike" *(ligji nr. 9072/2003)*. Në shkronjën "c", të nenit 43, të ligjit nr. 9072/2003, parashikohej se shoqëritë e shpërndarjes së energjisë elektrike janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e mjediseve dhe të pajisjeve, në përputhje me kërkesat teknike. Në Republikën e Shqipërisë prej vitit 2007, subjekti i interesuar, OSHEE-ja, i themeluar në formën e shoqërisë anonime, është subjekti përgjegjës që vepron në sektorin e shpërndarjes së energjisë elektrike. Për më tepër, referuar edhe statutit të tij, objekt i aktivitetit të tij (neni 4 i statutit), mes të tjerash, ka edhe: i. operimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të mjediseve dhe të pajisjeve në administrimin e tij në përputhje me kërkesat teknike; ii. menaxhimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike; iii. zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

31. Në vijim, Gjykata vëren se rregullat teknike në drejtim të distancave që duhet të respektohen në

vendosjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike janë të parashikuara në dy rregullore specifike të cilave iu janë referuar gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në vendimet e tyre. Konkretisht, në pikën 11.2, të rregullores së Kushteve Teknike të Projektimit parashikohet se në vendet e banuara, linjat elektrike ajrore (në gjendje të qetë, të pamënjanuara nga ndikimi i erës) duhet të jenë 10 metra larg nga objektet e banimit. Ndërsa në pikën 5.5. të rregullores së Sigurimit dhe të Shfrytëzimit Teknik parashikohet se largësia horizontale nga përcjellësit anësorë për zhvendosjen më të madhe të përcjellësve të linjës deri në pjesët me të afërta të objekteve që ndodhen ose ndërtohen duhet të jetë jo më e vogël se 2 metra për tensionin deri 20 kV.

32. Sikurse u parashtrua në rrethanat e këtij rasti *(shih paragrafët 1–2 të vendimit),* çështja në shqyrtim lidhet me humbjen e jetës së djalit të kërkuesve, si pasojë e ushtrimit të një aktiviteti që përbën burim rreziku të shtuar, konkretisht shpërndarja e energjisë elektrike. Kërkuesit i janë drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm duke paraqitur pretendimin për shpërblimin e dëmit që lidhej me humbjen e jetës së familjarit të tyre, si rezultat i mosveprimit të paligjshëm të organeve shtetërore për të garantuar sigurinë e jetës. Pretendimi është me natyrë kushtetuese, sepse lidhet me të drejtën e jetës të garantuar nga neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së. Konkretisht, pretendimi i kërkueseve lidhet me detyrimin pozitiv të shtetit për të marrë masat e nevojshme për të përcaktuar faktet dhe përgjegjësinë e personave përgjegjës, si dhe për t'i ofruar dëmshpërblimin e duhur viktimës në rastin kur vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit ka ardhur si rezultat i neglizhencës së shtetit.

33. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet, ka vlerësuar se humbja e jetës ka ndodhur për shkak të kontaktit të padëshiruar me përcjellësin ajror elektrik, pasi OSHEE-ja ka vendosur këta përcjellës në rrugën "Turizëm–Kanali i Çukës" në shkelje të rëndë të distancave të lejuara me objektet e banimit. Humbja e jetës të të afërmit të kërkuesve (lidhja shkakësore) ka qenë pasojë e drejtpërdrejtë, e menjëhershme e vendosjes së linjës elektrike të tensionit 10 kV në shkelje të nenit 11.2, të rregullores së Kushteve Teknike të Projektimit, që parashikon se në vendet e banuara linja elektrike ajrore (në gjendje të qetë) duhet të jetë 10 metra larg nga objektet e banimit dhe në rastin konkret ka qenë 1.98–2 metra. Gjithashtu, është shkelur edhe pika 5.5, e rregullores së Sigurimit Teknik, që parashikon se largësia horizontale nga përcjellësi anësor në zhvendosjen me të madhe të përcjellësve deri në pikën më të afërt të objekteve duhet të jetë jo më e vogël se 2 metra për tensionin deri në 20 kV *(shih faqet 5 dhe 10, të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë).* Ndërsa Gjykata e Apelit Gjirokastër, megjithëse ka vlerësuar në të njëjtën linjë, sikurse edhe gjykata e shkallës së parë, për shkeljen e parashikimeve të rregulloreve teknike të sipërcituara, ka arritur në përfundimin se distanca 2 metra largësi e linjës ruhet nëse ajo nuk pëson lëkundje, si pasojë e erës dhe nga kërkuesit/palë paditëse nuk është provuar nëse ditën e ngjarjes ka pasur erë, e cila mund të ketë bërë që distanca e linjës së zhvendosur të ishte më e vogël se 2 metra. Sipas gjykatës së apelit, edhe nëse do të zbatoheshin largësitë dhe do të kishte fryrë erë, që do të zhvendoste linjën në distancën 2 metra (distanca minimale), përsëri do të kishte ndodhur aksidenti për shkak të pakujdesisë së viktimës duke vendosur në përfundim rrëzimin e kërkesëpadisë për shpërblimin e dëmit *(shih faqet 15–16, të vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër).* Në vijim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, gjatë gjykimit të çështjes në dhomën e këshillimit, ndonëse gjendej përpara një pretendimi me natyrë kushtetuese (e drejta e jetës), ka vlerësuar se rekursi nuk përmbante shkaqe të parashikuara nga ligji.

34. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata vëren se vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për të përcaktuar pasjen ose mungesën e përgjegjësisë civile nga dëmet e shkaktuara nga linjat e shpërndarjes së energjisë elektrike janë fokusuar në analizën e distancave fizike të linjës elektrike nga zona e banuar sipas dy rregulloreve teknike të sipërpërmendura. Nga vendimi i Gjykatës së Apelit Gjirokastër rezulton se, ndonëse kjo gjykatë ka pranuar ekzistencën e mosrespektimit të disa standardeve teknike në lidhje me vendosjen e linjës elektrike, përsëri ka arritur në përfundimin e mungesës së përgjegjësisë së OSHEE-së. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se gjykata e apelit nuk ka evidentuar detyrimet pozitive, ndërkohë kur sipas jurisprudencës së Gjykatës rezulton se detyrimi pozitiv i shtetit jo vetëm duhet të ekzistojë në teori, por duhet të zbatohet edhe në praktikë, duke mundësuar përcaktimin e çdo përgjegjësie dhe marrjen e çdo mjeti juridik civil të

përshtatshëm *(shih vendimet nr. 10, datë 10.3.2026; nr. 63, datë 23.10.2025, të Gjykatës Kushtetuese).*

35. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk ka një analizë të detyrimeve pozitive që burojnë nga legjislacioni përkatës i sipërcituar (ligjet nr. 8734/2001 dhe nr. 9072/2003) për subjektin që shpërndan energjinë elektrike lidhur me mirëmbajtjen ose kontrollin periodik të linjave të shpërndarjes së energjisë elektrike, që përbën një veprimtari të rrezikshme të parashikuar në nenin 622 të Kodit Civil, si një nga rastet e përgjegjësisë pa faj. Veprimtaria e shpërndarjes së energjisë elektrike kërkon marrjen e masave konkrete administrative dhe teknike që lidhen jo vetëm me lejet për vendet ku vendosen linjat elektrike, por edhe me kontrolle të vazhdueshme dhe/ose periodike me natyrë mirëmbajtjeje, si dhe pajisjen me shenjat e nevojshme për të treguar rrezikshmërinë e tyre. Në këtë drejtim, gjykata e apelit nuk ka dhënë një shpjegim të plotë dhe bindës se përse shkelja e standardeve të tjera teknike të vendosura për të garantuar sigurinë në raport me objektet e banimit, e pranuar edhe nga ajo vetë në arsyetimin e vendimit gjyqësor, nuk është konsideruar e rëndësishme për përcaktimin e përgjegjësisë së subjektit të interesuar. Kjo gjykatë në vendimin e saj nuk ka analizuar se përse konkurrimi i pakujdesisë së viktimës, në kushtet e një përgjegjësie të përzier e përjashton totalisht nga përgjegjësia subjektin e interesuar për shpërblimin e dëmit. Gjykata e apelit është bazuar vetëm në hipoteza nëse do të frynte erë dhe i ka kaluar barrën e provës kërkuesve që nuk kanë provuar nëse atë ditë frynte ose jo erë. Për rrjedhojë, gjykata e apelit ka interpretuar në mënyrë formale dhe *strictu sensu* kuadrin ligjor duke u mbështetur në dy rregulloret teknike, interpretim i cili nuk ka marrë në konsideratë qëllimin e akteve ligjore duke nxjerrë një përfundim hipotetik e duke përjashtuar *apriori* nga përgjegjësia institucionet që operojnë në fushën e shpërndarjes së energjisë elektrike.

36. Për sa i takon vendimit të Gjykatës së Lartë, si gjykatë ligji, Gjykata vlerëson se vendimi është mbështetur në një arsyetim të përgjithshëm e formal, i cili është kufizuar në pohime standarde për respektimin e normave procedurale dhe zbatimin e ligjit material. Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtim të pretendimit të kërkuesve që interpretimi i kuadrit ligjor nga gjykata e apelit mohonte thelbin e së drejtës së jetës, për sa u takon detyrimeve pozitive të shtetit/institucioneve përgjegjëse për marrjen e masave për shpërndarjen e energjisë elektrike si fushë që përbën burim rreziku të shtuar edhe për jetën e individit me impakt dhe pasoja të ndjeshme dhe të drejtpërdrejta në sigurinë publike. Në këto rrethana, mospranimi i rekursit të kërkuesve nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me shqyrtimin *de plano* të çështjes dhe me arsyetimin e kufizuar se shkaqet e rekursit nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit me natyrë kushtetuese, për të drejtën e jetës, ka vënë në dyshim respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore kushtetuese të kërkuesve, si pasojë e mosmarrjes së masave nga institucioni përgjegjës në përputhje me parashikimet ligjore.

37. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se në rastin konkret është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim *të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.*

38. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesve është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-709, datë 19.2.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 6.5.2026.
Shpallur më 25.6.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji
Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sandër Beci, Marjana Semini
Anëtarë kundër: Asim Vokshi

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e çështjes që i përket kërkesës së kërkuesve Dhimë Qurku, Anastasia Qurku, me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 20-2019-984/413, datë 16.12.2019, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër; nr. 00-2025-709, datë 19.2.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, unë, gjyqtari Asim Vokshi, jam kundër vendimit të shumicës për pranimin e kërkesës, për arsyet e mëposhtme.

2. Shumica vendosi shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, pasi gjeti cenim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit, për shkak se ajo gjykatë nuk kishte mbajtur qëndrim të arsyetuar për pretendimin e kërkuesve të parashtruar në rekurs në lidhje me arsyet e dhëna nga Gjykata e Apelit Gjirokastër për rrëzimin e padisë.

3. Pakica vlerëson se nuk është në rolin e Gjykatës të korrektojë çdo gabim në vendimmarrjen e gjykatave të zakonshme, por të ndërhyjë vetëm në ato raste kur vendimmarrja e gjykatave të zakonshme nuk përmbush kriteret e një gjykimi të drejtë. Si rregull, vlerësimi i provave dhe i fakteve të çështjes u përket gjykatave të zakonshme dhe, në rastin konkret, ato kanë arsyetuar mjaftueshëm për sa i përket lidhjes shkakësore dhe shkakut determinant si kusht pa të cilin nuk ka përgjegjësi civile të të paditurit. Gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se janë respektuar kushtet minimale teknike për largësinë horizontale të përcjellësve të rrymës elektrike nga fasada e pallatit, por ngjarja ka qenë rast fatkeq për shkak të pakujdesisë së viktimës që ka sjellë ardhjen e pasojës së dëmshme. Kjo pasi viktima, duke mbajtur në dorë një tub prej metali rreth 6 metra të gjatë, është hasur në linjën elektrike dhe për këtë shkak ka ardhur pasoja. Ekzistenca e ndonjë tabele paralajmëruese në shtyllën e tensionit (siç pretendojnë kërkuesit) nuk është e qartë sesi do të ndikonte në shmangien e pasojës së dëmshme.

4. Idealisht që dëmi të shmangej do të duhej që të mos kishte fare linjë ajrore me përcjellës rryme të zhveshur në një zonë të banuar, por kjo nuk është çështja në këtë rast. Çështja është nëse instalimi, ashtu siç ishte dhe siç mundësonte stadi i zhvillimit të infrastrukturës energjetike në atë kohë, ka qenë sipas parametrave minimalë teknikë, për aq sa e lejonte mjedisi urban në të cilin kalonte përcjellësi. Duke qenë se është respektuar distanca sipas rregullores teknike (minimumi 2 metra) dhe njëkohësisht bëhet fjalë për një linjë furnizimi me energji elektrike që kalon në një zonë të banuar, ku në të dyja anët e rrugës janë ndërtuar ndërtesa të larta pas viteve '90, duket se nuk ka pasur mënyrë tjetër për furnizim me energji elektrike përveç infrastrukturës që ishte në vend në atë kohë. Jam i mendimit se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar mjaftueshëm kur kanë arritur në përfundimin se pas marrjes edhe të mendimit të specializuar të ekspertëve, dëmi ka ardhur për shkak të pakujdesisë së vet viktimës dhe jo për shkak të mosrespektimit të ndonjë kushti teknik. Gjykata e apelit ka vlerësuar përfundimet e ekspertëve dhe ka arritur në këtë përfundim. Gjykatat e faktit, duke konstatuar respektimin e kritereve minimale të rregulloreve të sigurimeve teknike dhe duke mbetur ardhja e pasojës vetëm te fakti i gjatësisë së tubit që kishte në duar viktima e që solli pasojën e dëmshme, vlerësoj se janë përmbushur kriteret e nenit 622 të Kodit Civil për përjashtimin e OSHEE-së nga përgjegjësia, në rastin konkret. Meqenëse thelbi i çështjes lidhet me vlerësimin e provave dhe Gjykata e Lartë nuk ka juridiksion për vlerësimin e tyre, mendoj se vendimi i asaj gjykate është marrë konform dispozitave përkatëse procedurale kur ka vendosur mospranimin e rekursit, duke arsyetuar se ai nuk ngrinte shkaqe sipas nenit 472 të KPC-së, ndaj nuk kishte vend për cenimin e kësaj vendimmarrjeje dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë.

Anëtar: Asim Vokshi

VENDIM
Nr. 64, datë 2.6.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Ilir Toska	anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 2.6.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 56 (A) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Alma Lleshi

SUBJEKT I INTERESUAR:

Avokatura e Shtetit, përfaqësuar nga avokati i shtetit Gramoz Meçani.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-3017, datë 9.7.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurës së gjykimit nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm për çështjen me nr. 7338 akti dhe nr. sistemi 21326-02885-30-2021, datë regjistrimi 16.11.2021.

Urdhërimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të procedojë brenda afatit të arsyeshëm për shqyrtimin e çështjes nr. 7338 akti dhe nr. sistemi 21326-02885-30-2021, datë regjistrimi 16.11.2021.

Konstatimi i mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave të lartpërmendura.

Rehabilitimi dhe zhdëmtimi në përputhje me ligjin për dëmin e shkaktuar për shkak të mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Caktimi i një shpërblimi të drejtë referuar vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut "*Olivieri dhe të tjerë kundër Italisë", "Verrascina dhe të tjerë kundër Italisë"* dhe *"ARB sh.p.k. dhe të tjerë kundër Shqipërisë".*

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 44, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6/1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës).*

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses Alma Lleshi (*kërkuesja)*, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja ka qenë në marrëdhënie pune, si mësuese, në shkollën 9-vjeçare "Demir Gashi", në Peshkopi, nga data 14.11.2016 deri në zgjidhjen e kontratës së punës me vendimin nr. 8, datë 17.6.2020 të drejtorisë së shkollës, me arsyetimin se kishte përfunduar afati i parashikuar në kontratën e punës nr. 2 prot., datë 2.9.2019.

2. Duke mos qenë dakord me zgjidhjen e kontratës së punës, kërkuesja i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi kundër Zyrës Arsimore Vendore Dibër dhe shkollës 9-vjeçare "Demir Gashi", Peshkopi, duke kërkuar: a) deklarimin e pavlefshmërisë së zgjidhjes së kontratës së punës nga pala e paditur dhe rikthimin në vendin e mëparshëm të punës; b) detyrimin e palës së paditur për ta dëmshpërblyer: i. me 2 paga mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës; ii. me 2 paga mujore për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës; iii. me 12 paga mujore për zgjidhje të kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara; iv. me 2 paga mujore për vjetërsi në punë; c) detyrimin e palës së paditur për t'i paguar lejen vjetore të punës në masën 45 ditë kalendarike.

3. Çështja është regjistruar në datën 16.12.2020 dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. 151 (33-2021-318), datë 14.4.2021, ka vendosur

pranimin e pjesshëm të padisë, duke urdhëruar: 1) detyrimin e palës së paditur për ta dëmshpërblyer kërkuesen me 10 paga mujore për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara, me 2 paga mujore për mosrespektimin e procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës, me 2 paga mujore për mosrespektimin e afatit të njoftimit, me 2 paga mujore për vjetërsinë në punë, si dhe për t'i paguar lejen vjetore të punës në masën 45 ditë kalendarike; 2) rrëzimin e padisë për pjesën tjetër. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur dhe çështja është regjistruar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në datën 16.11.2021, me nr. 21326-02885-30-2021.

4. Gjatë kohës që çështja ishte në pritje për shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në datën 20.11.2023 kërkuesja i është drejtuar asaj gjykate me kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, por nuk ka marrë përgjigje. Në datën 11.3.2025 kërkuesja i është drejtuar sërish asaj gjykate me të njëjtën kërkesë dhe në përgjigje, me shkresën nr. 9601/1, datë 2.6.2025, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm e ka informuar se është caktuar gjyqtari relator i çështjes dhe çështja është në pritje për t'u planifikuar për gjykim, për shkak se janë ende duke u gjykuar çështje gjyqësore të regjistruara në vitet 2017-2018.

5. Në datën 9.6.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, bazuar në nenet 399/1 e vijuese të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)*. Gjykata e Lartë, bazuar në nenin 399/5 të KPC-së, ia ka dërguar kërkesën Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si gjykatës para së cilës pretendohej vonesa. Kjo e fundit, kërkesën, bashkë me informacionin e gjyqtares relatore të çështjes së kërkueses, ia ka dërguar sërish Gjykatës së Lartë, ku çështja është regjistruar në datën 27.6.2025.

6. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës së kërkueses, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-3017, datë 9.7.2025, ka vendosur rrëzimin e saj. Sipas atij kolegji, ndonëse afati ligjor 2-vjeçar për gjykimin e çështjes së kërkueses ishte tejkaluar, mosveprimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime ose qëndrime abuzive të gjyqtares relatore, por për shkak të pamundësisë objektive të asaj gjykate, si rezultat i ngarkesës së madhe të krijuar nga akumulimi ndër vite i dosjeve dhe reduktimi i numrit të gjyqtarëve aktivë në sistem, një problematikë e përgjithshme kjo që tejkalon rastin konkret dhe lidhet me pasojat e reformës në drejtësi. Sipas atij kolegji, mekanizmi zhbllokues i projektuar nga nenet 399/1–399/12 të KPC-së përjashtohet nga zbatimi në rastet e pamundësisë objektive për procedim, gjë e cila nuk pengon ligjvënësin ose autoritetet e tjera vendimmarrëse që, në bazë edhe të orientimeve të Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata),* ndër të tjera, në vendimin nr. 39, datë 9.12.2021, të parashikojnë zgjidhje të tjera ligjore efektive për përballimin e situatës.

7. Po ashtu, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka theksuar se nuk mund të urdhërohet përshpejtimi i çështjes së kërkueses në kushtet kur Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është e ngarkuar me çështje shumë më të vjetra, që datojnë nga viti 2017. Për këtë arsye, përshpejtimi i çështjes së saj do të cenonte parimin e barazisë para ligjit, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, i cili gjen zbatim edhe në rregullat e vendosura në nenin 460 të KPC-së për radhën e gjykimit të çështjeve në apel, ku çështja e regjistruar më parë, sidomos kur ka të njëjtën natyrë, ka përparësi ndaj çështjes së regjistruar më vonë. Në këtë kuptim, sipas atij kolegji, paraqitja e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nuk mund të shërbejë si mekanizëm për cenimin e këtij parimi kushtetues, përveç rasteve kur veçantia e natyrës së çështjes ose e rrethanave subjektive justifikon përjashtimin nga radha e zakonshme e gjykimit. Në rastin konkret, ka vlerësuar ai kolegj, natyra e çështjes së kërkueses, megjithëse mund të gëzojë njëfarë përparësie ndaj çështjeve të tjera me natyrë të ndryshme, nuk rezulton të ketë prioritet në krahasim me çështjet e tjera të së njëjtës natyrë, pra ato që lidhen me marrëdhënie pune. Po sipas tij, kërkuesja nuk ka paraqitur dhe provuar ekzistencën e shkaqeve veçanërisht të rënda që do të justifikonin përshpejtimin e çështjes së saj dhe as ka provuar se çështja e saj ndodhet më përpara në radhën e pritjes krahasuar me çështje të tjera të së njëjtës kategori. Kolegji Civil ka vlerësuar, gjithashtu, se gjendja ekonomike ose familjare e kërkueses pas largimit nga puna nuk mund të përbëjë një situatë veçanërisht të rëndë, sikurse kërkon neni 460 i KPC-së, për të justifikuar përshpejtimin e çështjes së saj. Sipas kolegjit, papunësia e kërkueses ka ekzistuar që

nga viti 2021 dhe nuk mund të thuhet *a priori* se vonesa e gjykimit në apel, vetëm një vit përtej kohës së arsyeshme të gjykimit në këtë shkallë, ka ndikuar në rëndimin e gjendjes së saj ekonomike në raport me periudhën menjëherë pas largimit nga puna, ndërkohë që kërkuesja rezultonte e aftë për punë dhe nuk provoheshin pengesa që do ta pamundësonin atë të siguronte të ardhura nga një punë tjetër.

8. Në datën 2.12.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual sipas objektit. Ky ankim, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar më 15.12.2025. Me vendimin e datës 16.2.2026, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Po kështu, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e kërkesës së një anëtari të Gjykatës për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. ***Kërkuesja*** ka pretenduar, në mënyrë të përmbledhur, se i është cenuar:

9.1. E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të *së drejtës për gjykim brenda një afatit të arsyeshëm,* pasi:

9.1.1. Edhe pse kanë kaluar më shumë se 4 vjet nga momenti kur çështja është regjistruar në gjykatën e apelit dhe më shumë se 5 vjet nga paraqitja e padisë, si dhe pavarësisht se ajo ka përdorur mjetet juridike në dispozicion për përshpejtimin e procedurës së gjykimit, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nuk ka marrë asnjë masë efektive për gjykimin e saj. Kjo vonesë nuk është shkaktuar nga sjellja procedurale e kërkueses dhe çështja nuk paraqet kompleksitet ose vështirësi të tilla që të justifikojnë zvarritjen e gjykimit.

9.1.2. Mosveprimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ndryshe nga sa ka arsyetuar Gjykata e Lartë në lidhje me "pamundësinë objektive", nuk mund të justifikohet me ngarkesën e gjykatës, reformën në drejtësi ose mungesën e gjyqtarëve, pasi këto janë problematika shtetërore që nuk duhet të rëndojnë mbi individin, sikurse është pranuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ).*

9.1.3. Vonesa në gjykimin e çështjes i ka shkaktuar kërkueses pasoja negative, duke pasur parasysh interesat e saj vetjakë dhe kushtet ekonomiko-familjare. Nisur nga natyra e mosmarrëveshjes, e cila lidhet me marrëdhënien e punës, gjykimi i saj paraqet urgjencë, sikurse është pranuar në jurisprudencën kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, si dhe në vendimin nr. 78, datë 30.5.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit", të ndryshuar. Gjykata e Lartë nuk ka referuar asnjë vendimmarrje të GJEDNJ-së për të mbështetur përfundimin se gjendja ekonomike ose familjare e kërkueses pas largimit nga puna nuk përbën një situatë veçanërisht të rëndë që të justifikojë përshpejtimin e çështjes. Kërkuesja ka dy fëmijë, të cilët në momentin e largimit të saj nga puna kanë qenë duke ndjekur studimet e larta në Tiranë dhe vijojnë të jetojnë me qira në këtë qytet, ndërsa bashkëshorti i saj është i papunë. Për shkak të kësaj gjendjeje, në datat 31.10.2019 dhe 9.6.2025, ajo është detyruar të marrë kredi bankare.

9.1.4. Mjeti juridik i parashikuar nga KPC-ja për mbrojtjen e së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, në mënyrën sesi është interpretuar dhe zbatuar nga gjykatat, nuk është efektiv, pasi kërkueses nuk i është ofruar një zgjidhje reale për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së saj.

9.2. E drejta për dëmshpërblim, pasi rrëzimi nga Gjykata e Lartë i kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për gjykimin e çështjes nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm i ka mohuar asaj edhe të drejtën e dëmshpërblimit. Kërkuesja vijon të ruajë statusin e viktimës për shkak të shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe se, bazuar në nenin 44 të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 8510/1999, "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore", duhet t'i akordohet një dëmshpërblim i arsyeshëm, në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së. Mosakordimi i një dëmshpërblimi të tillë, krahas urdhërimit për përshpejtimin e gjykimit të çështjes, rrezikon ta bëjë mekanizmin procedural të përdorur joefektiv për qëllime të nenit 13 të KEDNJ-së, të interpretuar së bashku me nenin 6/1 të saj. Gjithsesi, një zgjidhje e pranueshme për kërkuesen do të ishte konstatimi nga Gjykata i shkeljes vijuese dhe vazhduese të së

drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

10. ***Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit,*** në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se nuk qëndron pretendimi kryesor i kërkueses për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me të cilin lidhen edhe pretendimet për të drejtën për një mjet juridik efektiv dhe të drejtën për një shpërblim të drejtë, pasi:

10.1. Vendimmarrja e Gjykatës së Lartë është e arsyetuar, shteruese dhe e mbështetur në parashikimet e neneve 399/5-399/8 të KPC-së.

10.2. Ndonëse formalisht gjykimi i çështjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka tejkaluar afatin ligjor 2-vjeçar për përfundimin e gjykimit në shkallë të dytë, sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja "b", të KPC-së, duhen mbajtur parasysh kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: i. sjelljen e kërkueses, e cila nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes; ii. kompleksitetin e çështjes, e cila nuk paraqitet komplekse nga natyra e saj për sa kohë edhe gjykimi në shkallë të parë ka përfunduar në një afat prej më pak se 4 muaj; iii. sjelljen e autoriteteve, të cilat ndodhen në kushtet e një ngarkese të lartë të çështjeve për gjykim në gjykatën e apelit të shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi; iv. rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesja, e cila nuk ka paraqitur asnjë argument se vonesa në shqyrtimin e çështjes së saj ka sjellë pasoja të menjëhershme, jetike dhe ngushtësisht personale për t'i dhënë prioritet gjykimit të saj nga gjykata e apelit.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

11. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private ose publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

12. Kërkuesja, në ankimin kushtetues individual, ka kërkuar, ndër të tjera, edhe rehabilitimin dhe zhdëmtimin në përputhje me ligjin, përmes caktimit drejtpërdrejt nga Gjykata të një shpërblimi të drejtë në vlerë monetare. Gjykata, bazuar në nenin 131 të Kushtetutës, ka pohuar se pretendimet për të drejtën për dëmshpërblim, sipas neneve 399/6 dhe 399/10 të KPC-së, si rrjedhojë e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit në gjykatat e zakonshme, nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues *(shih vendimin nr. 29, datë 30.4.2025; nr. 31, datë 29.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese)*. Për këtë arsye, ky kërkim nuk mund të merret në shqyrtim.

13. Në verifikim të kritereve të legjitimit në rastin konkret, Gjykata vlerëson se kërkuesja, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në Gjykatën e Lartë, vendimin e së cilës e kundërshton, si dhe palë në procesin gjyqësor që vijon të jetë në pritje për shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për të cilin pretendon se i është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Për rrjedhojë, ajo ka interes të drejtpërdrejtë dhe real në çështjen e parashtruar.

14. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i Ligjit Organik të Gjykatës, Gjykata vëren se kërkuesja, përpara paraqitjes së ankimit kushtetues individual, ka përdorur mjetin e posaçëm procedural të parashikuar nga nenet 399/1 e vijuese të KPC-së, duke kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit të çështjes së saj në apel. Ky mjet është përfunduar me vendimin nr. 00-2025-3017, datë 9.7.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me të cilin kërkesa është rrëzuar. Në këto rrethana, për pretendimet që lidhen me vijimin e vonesës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, kërkuesja nuk ka mjet tjetër juridik efektiv në dispozicion, përveç ankimit kushtetues individual.

15. Kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi jo vetëm që shkelja e pretenduar ka natyrë vazhduese, por edhe sepse vendimi i Gjykatës së Lartë, objekt ankimi, ndonëse mban datën 9.7.2025 dhe është publikuar në faqen zyrtare të asaj gjykate në datën 13.10.2025, i është njoftuar kërkueses me shkresën e datës 20.10.2025, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 2.12.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik të Gjykatës.

16. Për sa i përket kriterit të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, të së drejtës për një mjet juridik efektiv dhe të së drejtës për dëmshpërblim. Në këtë kuptim, ajo ka kërkuar, krahas shfuqizimit të vendimit nr. 00-2025-3017, datë 9.7.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, edhe konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së gjykimit nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, konstatimin e mungesës së një mjeti juridik efektiv për konstatimin, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e kësaj procedure, konstatimin e statusit të "viktimës" si pasojë e shkeljes së afatit të arsyeshëm, si dhe rehabilitimin dhe zhdëmtimin në përputhje me ligjin, përmes caktimit të një shpërblimi të drejtë.

17. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkueses, Gjykata vlerëson se ato bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Këto pretendime lidhen me konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për shkak të mosgjykimit në kohë të çështjes civile nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me efektivitetin e mjetit juridik të përdorur për konstatimin dhe përshpejtimin e procedurës, si dhe me ruajtjen e statusit të viktimës për shkak të mungesës së një riparimi të përshtatshëm të shkeljes së pretenduar. Duke pasur parasysh natyrën dhe lidhjen e ngushtë ndërmjet tyre, Gjykata çmon t'i analizojë këto pretendime në drejtim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, si pretendimi kryesor nga i cili burojnë edhe pretendimet e tjera.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

18. Kërkuesja ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pasi, edhe pse kanë kaluar më shumë se 4 vjet nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe më shumë se 5 vjet nga paraqitja e padisë, ajo gjykatë nuk ka marrë asnjë masë efektive për shqyrtimin e çështjes. Sipas saj, vonesa nuk është shkaktuar nga sjellja e saj procedurale dhe çështja nuk paraqet kompleksitet ose vështirësi të tilla që të justifikojnë zvarritjen e gjykimit. Kërkuesja ka pretenduar, gjithashtu, se mosveprimi i gjykatës së apelit nuk mund të justifikohet me ngarkesën e saj, reformën në drejtësi ose mungesën e gjyqtarëve, pasi këto janë problematika shtetërore që nuk duhet të rëndojnë mbi individin. Ajo ka parashtruar se, për shkak të natyrës së mosmarrëveshjes, e cila lidhet me marrëdhënien e punës, si dhe për shkak të kushteve të saj ekonomiko-familjare, çështja paraqet urgjencë dhe vonesa në gjykim i ka shkaktuar pasoja negative. Po ashtu, sipas kërkueses, mjeti juridik i parashikuar nga KPC-ja për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, për shkak të mënyrës sesi është interpretuar dhe zbatuar nga gjykatat, nuk i ka ofruar asaj një riparim real dhe efektiv.

19. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se pretendimi kryesor i kërkueses për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm nuk qëndron dhe, për rrjedhojë, nuk qëndrojnë as pretendimet e lidhura me të për mungesën e një mjeti juridik efektiv dhe për të drejtën për shpërblim të drejtë. Sipas tij, vendimmarrja e Gjykatës së Lartë është e arsyetuar, shteruese dhe e mbështetur në nenet 399/5–399/8 të KPC-së. Avokatura e Shtetit ka parashtruar se, ndonëse formalisht gjykimi i çështjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka tejkaluar afatin ligjor 2-vjeçar për përfundimin e gjykimit në shkallë të dytë, në rastin konkret duhet të mbahen parasysh kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese. Në këtë drejtim, ajo ka theksuar se kërkuesja nuk rezulton të ketë shkaktuar vonesa në gjykim, çështja nuk paraqitet komplekse, autoritetet gjyqësore janë përballur me ngarkesë të lartë për shkak të reformës në drejtësi, ndërsa kërkuesja nuk ka provuar se vonesa i ka sjellë pasoja të menjëhershme, jetike dhe ngushtësisht personale që do të justifikonin dhënien përparësi gjykimit të çështjes së saj.

20. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi

brenda një afati të arsyeshëm. Gjykata ka theksuar se kjo e drejtë është element përbërës i procesit të rregullt ligjor. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit përfundimtar dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 57, datë 17.9.2024; nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese).*

21. Në rastin konkret, Gjykata vëren se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje në datën 16.12.2020, me kërkesëpadinë e paraqitur nga kërkuesja, nëpërmjet së cilës ajo ka kërkuar pavlefshmërinë e zgjidhjes së kontratës së punës, rikthimin në vendin e mëparshëm të punës, si dhe dëmshpërblimet përkatëse për shkak të zgjidhjes së menjëhershme e të pajustifikuar të kontratës individuale të punës, mosrespektimit të procedurës dhe të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, shpërblimin për vjetërsi në punë dhe pagimin e pagës për lejen vjetore të pakryer. Gjykimi i themelit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë ka përfunduar në datën 14.4.2021. Më pas, mbi ankimin e palës së paditur, çështja është regjistruar në gjykatën e apelit në datën 16.11.2021. Pas më shumë se 3 vjetësh e 6 muajsh nga regjistrimi i çështjes në apel, ndonëse kërkuesja ka kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit, Gjykata e Lartë, në datën 9.7.2025, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Aktualisht, deri në momentin e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual, çështja vijon të jetë në pritje për gjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Sipas informacionit të kësaj gjykate, të datës 11.5.2026, çështja e kërkueses, pas disa rishortimeve, së fundi, në datën 10.3.2026, i ka kaluar për gjykim një gjyqtari relator të ri, i cili ka një ngarkesë prej rreth 1200 dosjesh civile, ndër të cilat rreth 200 kanë për objekt mosmarrëveshje pune, ndërkohë që aktualisht ai po shqyrton çështje të regjistruara në vitet 2018 dhe 2019.

22. Lidhur me afatet e gjykimit të çështjeve civile, KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljes të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 2-vjeçar për përfundimin e gjykimit në gjykatën e apelit (neni 399/2, pika 1, shkronja "b", i KPC-së). Në rastin konkret, ky afat është tejkaluar dukshëm. Megjithatë, tejkalimi i afatit ligjor nuk çon automatikisht në konstatimin e shkeljes së nenit 42 të Kushtetutës, por përbën një tregues të rëndësishëm që duhet vlerësuar në raport me rrethanat konkrete të çështjes dhe kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese dhe konventore. Për rrjedhojë, Gjykata do ta vlerësojë këtë tejkalim në raport me kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për tejzgjatjen e paarsyeshme të gjykimit, të cilat konsistojnë në: i. sjelljen e kërkuesit; ii. kompleksitetin e çështjes; iii. sjelljen e autoriteteve; iv. rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi *(shih vendimet nr. 21, datë 4.4.2024; nr. 68, datë 7.12.2023; nr. 6, datë 16.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese).*

23. Për sa u përket kritereve që lidhen me *sjelljen e kërkueses* dhe *kompleksitetin e çështjes,* Gjykata vëren se nuk rezulton ndonjë rrethanë që të tregojë se kërkuesja ka shkaktuar ose ka ndikuar në vonesën e gjykimit. Përkundrazi, ajo ka përdorur mjetet në dispozicion për përshpejtimin e procedurës, duke iu drejtuar fillimisht Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe më pas Gjykatës së Lartë sipas neneve 399/1 e vijuese të KPC-së. Po ashtu, çështja nuk paraqitet komplekse, pasi lidhet me një mosmarrëveshje pune, me objekt pavlefshmërinë e zgjidhjes së kontratës dhe kërkimin e dëmshpërblimit, e cila është shqyrtuar në shkallë të parë brenda një periudhe relativisht të shkurtër. Edhe Gjykata e Lartë, në vendimin e kundërshtuar, nuk ka identifikuar si shkaqe të vonesës sjelljen e kërkueses ose kompleksitetin e çështjes. Për rrjedhojë, analiza e Gjykatës do të përqendrohet në *sjelljen e autoriteteve* dhe *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesja,* për shkak të vonesës së gjykimit të çështjes së saj.

24. Në lidhje me sjelljen e autoriteteve, Gjykata ka theksuar se shteti ka detyrimin pozitiv të organizojë sistemin gjyqësor në mënyrë të tillë që gjykatat të jenë në gjendje të garantojnë të drejtën e çdo individi për një vendim përfundimtar brenda një afati të arsyeshëm. Ajo ka pranuar se reforma në drejtësi dhe procesi i rivlerësimit kalimtar, pa mohuar nevojën, rëndësinë dhe përfitimet, kanë krijuar pasoja të ndjeshme në funksionimin e sistemit gjyqësor, veçanërisht për shkak të vakancave dhe ngarkesës së krijuar në gjykata. Megjithatë, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se këto rrethana, ndonëse mund të merren në konsideratë

në vlerësimin e përgjithshëm të çështjes, nuk mund të shërbejnë, në vetvete, si justifikim i mjaftueshëm për vonesa të tejzgjatura, aq më tepër kur ato kthehen në problem strukturor të organizimit të gjyqësorit. Në raste të tilla, shteti, përmes autoriteteve përgjegjëse, duhet të ndërhyjë me masa efektive ligjore, organizative dhe institucionale për të garantuar realisht të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm *(shih vendimet nr. 68, datë 7.12.2023; nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese).*

25. Në të njëjtën linjë, GJEDNJ-ja ka pohuar se shtetet kanë detyrimin të organizojnë sistemet e tyre gjyqësore në mënyrë që gjykatat të përmbushin kërkesat e nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së, përfshirë edhe kërkesën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm *(shih Comingersoll S.A. kundër Portugalisë [DHM], 2000, §§ 19,24; Frydlender kundër Francës [DHM], 2000, § 43).* Në çështjet kundër Shqipërisë, GJEDNJ-ja ka theksuar posaçërisht se reforma në drejtësi, sado e rëndësishme dhe komplekse, nuk e përjashton shtetin nga detyrimi për të garantuar gjykimin brenda një afati të arsyeshëm dhe se vonesat serioze nuk mund të justifikohen vetëm me referimin te backlog-u ose vakancat në sistem. Faktorë të përgjithshëm, si reforma në drejtësi, procesi i rivlerësimit kalimtar (*vetting*-u), vakancat ose numri i lartë i çështjeve të prapambetura, mund të merren parasysh në një masë të përshtatshme në vlerësimin e kohëzgjatjes së procedurave në një çështje të veçantë, por, të vetëm, nuk mund të justifikojnë vonesa të një shkalle të tillë *(shih Bara dhe Kola kundër Shqipërisë, 2021, §§ 69-72; ARB sh.p.k. dhe të tjerë kundër Shqipërisë, 2025, §§ 119–123).*

26. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, në vendimin e kundërshtuar, e ka pranuar tejkalimin e afatit ligjor 2-vjeçar për gjykimin e çështjes në apel, por ka vlerësuar se vonesa nuk i atribuohet sjelljes subjektive të gjyqtares relatore, por pamundësisë objektive të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për shkak të ngarkesës së madhe të krijuar nga akumulimi ndër vite i dosjeve dhe reduktimi i numrit të gjyqtarëve aktivë në sistemin gjyqësor. Gjykata, duke vërejtur se qëndrimi i Gjykatës së Lartë është mbajtur edhe në çështje të tjera të kësaj natyre, thekson se ai nuk pajtohet me standardin kushtetues dhe konventor të konsoliduar për të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e Gjykatës dhe atë të GJEDNJ-së, në vijimësi është theksuar se vështirësitë strukturore të sistemit gjyqësor, ngarkesa e gjykatave, vakancat ose pasojat e reformës në drejtësi mund të merren parasysh në vlerësimin e kohëzgjatjes së procedurave, por ato, të vetme, nuk mund të justifikojnë vonesa të tejzgjatura dhe as të zhvendosin mbi individin barrën e pasojave të vështirësive në funksionimin e sistemit gjyqësor. Standardi i nenit 42 të Kushtetutës nuk kufizohet vetëm në mungesën e fajit subjektiv të gjyqtarit relator ose të gjykatës konkrete, por kërkon të vlerësohet nëse shteti, përmes autoriteteve përgjegjëse për organizimin, administrimin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë, ka marrë masat e nevojshme ligjore, institucionale dhe organizative për të garantuar shqyrtimin e çështjeve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm. Për rrjedhojë, fakti se vonesa lidhet me shkaqe strukturore nuk e përjashton përgjegjësinë kushtetuese të autoriteteve publike për garantimin efektiv të kësaj të drejte dhe nuk mund të shërbejë si bazë për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm.

27. Në lidhje me kriterin e asaj çfarë rrezikon kërkuesi, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë" duhet të trajtohen me shpejtësi e përparësi, të tilla si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin etj., edhe pse kjo listë nuk mund të jetë shteruese dhe interesi i kërkuesit verifikohet rast pas rasti *(shih vendimet nr. 54, datë 9.10.2025; nr. 43, datë 4.6.2024; nr. 21, datë 4.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese).* Edhe GJEDNJ-ja ka theksuar se mosmarrëveshjet e punësimit nga natyra e tyre kërkojnë një vendim të shpejtë, duke pasur parasysh atë që është në rrezik për personin në fjalë, i cili përmes pushimit nga puna humbet mjetet e tij të jetesës *(shih Frydlender kundër Francës [DHM], 2000, § 45).*

28. Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, në vendimin e kundërshtuar, ka vlerësuar se natyra e çështjes së kërkueses, ndonëse lidhet me marrëdhënie pune, nuk justifikon përparësi ndaj çështjeve të tjera të së njëjtës natyrë, ndërsa gjendja ekonomike dhe familjare e saj pas largimit nga puna nuk përbën situatë veçanërisht të rëndë në kuptim të nenit 460 të KPC-së. Sipas Gjykatës së Lartë, papunësia e kërkueses ka ekzistuar që nga viti 2021 dhe nuk mund të thuhet *a priori* se vonesa në apel ka rënduar gjendjen e saj ekonomike, për sa kohë ajo

rezulton e aftë për punë dhe nuk ka provuar pengesa që do të pamundësonin sigurimin e të ardhurave nga një punë tjetër. Gjykata çmon se ky arsyetim e interpreton në mënyrë tepër kufizuese kriterin e asaj çfarë rrezikon kërkuesja. Ky kriter nuk kërkon domosdoshmërisht provimin e një pamundësie absolute për të siguruar të ardhura ose të një gjendjeje ekstreme ekonomike, por vlerësimin e ndikimit real që vonesa ka mbi të drejtat dhe interesat vetjakë të kërkueses, duke mbajtur parasysh natyrën e mosmarrëveshjes, objektin e padisë dhe pasojat që lidhen me marrëdhënien e punës. Për më tepër, në mosmarrëveshjet e punës, rëndësia e asaj çfarë rrezikon individi nuk varet vetëm nga prova e një gjendjeje ekonomike ekstreme, por edhe nga natyra e marrëdhënies së punës, nga funksioni i saj si burim i të ardhurave dhe nga pasiguria juridike që krijohet për individin kur ligjshmëria e largimit nga puna mbetet për një kohë të gjatë pa përgjigje përfundimtare gjyqësore.

29. Në rastin konkret, mosmarrëveshja në shqyrtim përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm lidhet drejtpërdrejt me zgjidhjen e marrëdhënies së punës së kërkueses dhe me pretendimin e saj për paligjshmërinë e largimit nga puna, rikthimin në vendin e mëparshëm të punës dhe përfitimin e dëmshpërblimeve përkatëse. Pra, ajo nuk ka të bëjë thjesht me një interes pasuror të zakonshëm, por me marrëdhënien e punës si burim të të ardhurave dhe të sigurisë ekonomike të individit. Edhe pse gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, vendimi nuk ka marrë formë të prerë për shkak të ankimit të palës së paditur dhe çështja vijon të mbetet e pazgjidhur në apel prej më shumë se 4 vjetësh e 6 muajsh. Në këtë periudhë, kërkuesja ka mbetur në pasiguri juridike jo vetëm për ligjshmërinë e largimit të saj nga puna, por edhe për mundësinë e rikthimit në vendin e punës dhe për realizimin e të drejtave pasurore që lidhen me këtë marrëdhënie. Në këto rrethana, vonesa nuk ka vetëm natyrë formale ose procedurale, por ndikon në sigurinë juridike të kërkueses, në efektivitetin e një rezultati eventualisht të favorshëm për të dhe në realizimin e të drejtave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës. Sa më shumë zgjatet gjykimi, aq më shumë dobësohet dobia praktike e vendimit përfundimtar, veçanërisht në lidhje me kërkimin për rikthim në punë dhe me kompensimin për pasojat e largimit. Në këtë kuptim, vonesa në gjykim prek një interes të rëndësishëm personal dhe ekonomik të kërkueses. Për rrjedhojë, natyra e mosmarrëveshjes dhe rrethanat konkrete të saj justifikojnë trajtimin e çështjes me kujdes të shtuar nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

30. Për më tepër, referuar qëndrimit të GJEDNJ-së, Gjykata është shprehur se një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet si një kohë e arsyeshme dhe se palët në mosmarrëveshjet civile, edhe kur çështja nuk kërkon ndonjë trajtim të veçantë prioritar, kanë megjithatë të drejtën, sipas nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së, për një proces brenda një afati të arsyeshëm dhe nuk janë të detyruara të tregojnë, për këtë qëllim, se u është shkaktuar ndonjë dëm i veçantë ose shtesë nga vonesat procedurale. Gjithashtu, ajo ka theksuar se një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet e arsyeshme kur argumenti i vetëm për vonesën është reforma në sistemin e drejtësisë dhe ngarkesa e gjyqtarëve e krijuar për këtë shkak. Faktorë të tillë, të një natyre të përgjithshme, mund të merren parasysh në një masë të përshtatshme në vlerësimin e kohëzgjatjes së procedurave në një çështje të veçantë, por nuk janë të aftë, në vetvete, të justifikojnë vonesa të një mase të tillë *(shih vendimin nr. 54, datë 9.10.2025, të Gjykatës Kushtetuese).* Ky standard merr rëndësi të posaçme në rastin konkret, pasi nëse një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të justifikohet vetëm me vështirësitë strukturore të sistemit edhe në çështje civile që nuk kërkojnë trajtim të veçantë prioritar, aq më pak ajo mund të konsiderohet e arsyeshme në çështjen që lidhet me marrëdhënien e punës së kërkueses dhe me pasojat e largimit të saj nga puna.

31. Në lidhje me argumentin e Gjykatës së Lartë se përshpejtimi i çështjes së kërkueses do të cenonte parimin e barazisë para ligjit dhe radhën e shqyrtimit të çështjeve sipas nenit 460 të KPC-së, Gjykata vlerëson se ky shqetësim nuk është i pabazë. Respektimi i radhës kronologjike të gjykimit është, në parim, një kriter objektiv dhe i rëndësishëm për administrimin e drejtë të ngarkesës gjyqësore dhe për garantimin e barazisë ndërmjet subjekteve ndërgjyqëse. Po ashtu, në kushtet e një problematike të përgjithshme dhe strukturore në funksionimin e sistemit gjyqësor, përshpejtimi i çështjeve vetëm mbi bazën e kërkesave individuale mund të krijojë tension me radhën e zakonshme të shqyrtimit dhe, në rast përdorimi masiv të këtij mjeti, të shtojë më tej ngarkesën e gjykatave. Megjithatë, këto rrethana

nuk mund të shërbejnë si bazë e vetme për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës, pasi një qasje e tillë do ta bënte joefektiv mjetin e posaçëm procedural të parashikuar nga nenet 399/1 e vijuese të KPC-së. Për rrjedhojë, përparësia e shqyrtimit nuk mund të konceptohet si pasojë automatike e çdo kërkese individuale, por si masë që varet nga konstatimi gjyqësor i shkeljes dhe nga vlerësimi konkret i kohëzgjatjes së procedurës, natyrës së çështjes, rëndësisë së interesit të palës dhe rrethanave të tjera objektive.

32. Gjykata thekson se, kur një individ përdor një mjet juridik të parashikuar nga ligji dhe gjykata konstaton se në rastin konkret është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, urdhërimi i masave për të parandaluar vijimin e shkeljes nuk përbën, në vetvete, trajtim arbitrar ose të privilegjuar. Ai është pasojë e konstatimit gjyqësor të një shkeljeje konkrete dhe e nevojës për ta bërë mjetin juridik efektiv në praktikë. Nga ana tjetër, sikurse Gjykata ka theksuar në jurisprudencën e saj që prej vitit 2021 dhe sikurse GJEDNJ-ja ka evidentuar në çështjet kundër Shqipërisë *(shih në veçanti Bara dhe Kola kundër Shqipërisë, 2021; ARB sh.p.k. dhe të tjerë kundër Shqipërisë, 2025),* faktorë të përgjithshëm si reforma në drejtësi, vakancat, ngarkesa e gjykatave dhe numri i lartë i çështjeve të prapambetura mund të merren parasysh në vlerësimin e kohëzgjatjes së procedurës në një rast konkret, por, të vetëm, nuk mund të justifikojnë vonesa të theksuara. Për rrjedhojë, mungesa e masave të përgjithshme ligjore, organizative dhe institucionale për adresimin e çështjeve të prapambetura nuk mund t'i kundërvihet individit për të mohuar konstatimin e shkeljes ose riparimin e pasojave të saj. Përkundrazi, ajo evidenton nevojën për ndërhyrje të menjëhershme dhe të qëndrueshme nga autoritetet përgjegjëse, në mënyrë që e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm të mos garantohet vetëm rast pas rasti, por në mënyrë efektive për të gjitha subjektet ndërgjyqëse.

33. Në lidhje me pretendimin e kërkueses për mungesën e një mjeti juridik efektiv dhe ruajtjen e statusit të viktimës, Gjykata mban parasysh se, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, neni 13 i KEDNJ-së kërkon ekzistencën e një mjeti vendas që të jetë efektiv si në ligj, ashtu edhe në praktikë, pra i aftë të trajtojë thelbin e ankesës dhe të ofrojë një riparim të përshtatshëm *(shih Kudła kundër Polonisë [DHM], 2000, § 157; Sürmeli kundër Gjermanisë [DHM], 2006, §§ 98-101; ARB sh.p.k. dhe të tjerë kundër Shqipërisë, 2025, §§ 158–160).* Në rastin konkret, kërkuesja e ka përdorur mjetin e parashikuar nga nenet 399/1 e vijuese të KPC-së, por vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka njohur dhe riparuar shkeljen e pretenduar, ndërsa procedura kryesore në gjykatën e apelit vijon ende. Në këto kushte, për sa kohë nuk ka pasur as konstatim të shkeljes, as përshpejtim real të gjykimit dhe as ndonjë formë tjetër riparimi të përshtatshme, kërkuesja vijon të ruajë statusin e viktimës për qëllime të shqyrtimit kushtetues. Ky përfundim nuk nënkupton se mjeti i parashikuar nga nenet 399/1 e vijuese të KPC-së është në vetvete joefektiv, por se, në rrethanat konkrete, ai nuk i ka ofruar kërkueses riparimin e nevojshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

34. Në këtë këndvështrim, duke pasur parasysh se procesi gjyqësor vijon prej më shumë se 5 vjetësh e 5 muajsh, ndërsa vetëm në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm çështja është në pritje për t'u shqyrtuar prej më shumë se 4 vjetësh e 6 muajsh, se vonesa nuk i atribuohet sjelljes së kërkueses, se çështja nuk paraqet kompleksitet të veçantë, si dhe se mosmarrëveshja lidhet me marrëdhënien e punës, Gjykata arrin në përfundimin se në rastin konkret është cenuar e drejta e kërkueses për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, vendimi nr. 00-2025-3017, datë 9.7.2025, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duhet të shfuqizohet, pa e dërguar çështjen për shqyrtim në atë gjykatë. Në lidhje me këtë, Gjykata mban në konsideratë se shkelja e konstatuar lidhet me vijimin e vonesës në shqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe jo me nevojën për një rivlerësim të mëtejshëm nga Gjykata e Lartë. Për këtë arsye, dërgimi i çështjes në atë gjykatë nuk do të përbënte mjet të përshtatshëm për riparimin efektiv të shkeljes dhe do të rrezikonte të sillte zgjatjen e mëtejshme të procedurës. Në këto rrethana, Gjykata çmon se është rasti të konstatojë cenimin e së drejtës së kërkueses për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Po ashtu, Gjykata vlerëson se, për shkak të natyrës vazhduese të shkeljes, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm duhet të marrë masat e nevojshme për shqyrtimin me përparësi të çështjes së kërkueses, duke mbajtur parasysh standardet e këtij vendimi.

35. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa është e bazuar, ndaj ajo duhet pranuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-3017, datë 9.7.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
3. Konstatimin e cenimit të së drejtës së kërkueses për gjykim brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në çështjen civile nr. 21326-02885-30-2021, datë regjistrimi 16.11.2021.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 2.6.2026.
Shpallur më 25.6.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji
Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 368 lekë

||FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË|Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 141|Datë: 02.07.2026 15:45:17 +02:00|f65d7b61-e307-4b36-a1ca-4ffdd0e7708c

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë|të një procedure automatike nga një sistem elektronik|(Qendra e Botimeve Zyrtare)